



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

IMANI – BESIMI NË ALLAHUN

Muhamed el-Behij

Botuar nga: Zëri Islam

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

| | |
|---|----|
| BESIMI NË ALL-LLAHUN..... | 5 |
| BESIMI NË ALL-LLAHUN - MBËSHTETJA E BESIMTARIT | 8 |
| PERSONALITETI ËSHTË DOEMOS I LIRË NË ATË QË BESON..... | 11 |
| EPËRSIA E BESIMIT, E JO E BESIMTARIT..... | 16 |
| BESIMTARI I DOBËT DHE I FUQISHËM..... | 19 |
| Ç'PRITET NGA BESIMTARI NË IDEOLOGJINË DHE MORALIN E TIJ | 22 |
| BESIMTARI DHE FJALA E DHËNË..... | 26 |
| BESIMTARI DHE RESPEKTI | 29 |
| BESIMTARI DHE GRINDJA | 31 |
| BESIMTARI DHE PACENUESHMËRIA PERSONALE..... | 35 |
| FUQIA E BESIMTARIT | 38 |
| BESIMTARI NUK ËSHTË NË LAJTHITJE | 41 |
| STABILITETI I BESIMTARIT | 43 |
| BARABARËSIA DHE DHËNIA E PËRPARËSISË..... | 47 |
| MALLËNGJIMI PËR PASTËRTINË E SHPIRTIT | 50 |
| ALL-LLAHU □ DHE NJERIU NË ORIENTIM | 53 |

| | |
|---|-----|
| NDRYSHIMI SHOQËROR | 56 |
| FORCA MATERIALE E SHOQËRISË NUK ËSHTË GARANCI E VETME E EKZISTIMIT TË SAJ | 60 |
| NDIHMA E ALL-LLAHUT | 64 |
| E VËRTETA NUK VDES | 67 |
| ISLAMI NUK ËSHTË SPIRITUALIZËM I PASTËR AS MATERIALIZËM EKSTREM | 70 |
| SPROVAT NË KËTË BOTË..... | 73 |
| JETA E NJERIUT NDËRMJET PUSHIMIT DHE PUNËS..... | 76 |
| KUR FJALA NUK PËRCILLET ME VEPËR | 79 |
| NUK KA SHPËRBLIM PA SPROVA..... | 81 |
| LUTJA AFRON TEK ALL-LLAHU □ | 84 |
| JETA E TË DËRGUARIT TË ALL-LLAHUT -MISHËRIM I MISIONIT TË TIJ | 87 |
| FALJA E NAMAZIT TË XHUMASË NUK Ë NDËRPRET FURNIZIMIN..... | 93 |
| MUHAMMED EL-BEHIJ | 96 |
| - JETA DHE VEPRAT SHKURTIMISHT -..... | 96 |
| VEPRAT E M. EL-BEHIJ | 100 |

BESIMI NË ALL-LLAHUN

Besimi më All-llahun ﷻ nuk reduktohet vetëm në fjalë, në dëshmim, as në maksimën e shehadetit të cilën e shqipton gjuha, as në citatet kur'anore që lexohen në çastet kur nevojitet konfirmimi i lidhjes me Islamin.

Besimi nuk është as këshillë që i drejtohet tjetrit, as dije për fenë që i përcillet tjetrit, të paudhëzuarit në çështjen e fesë. Besimi nuk është as profesion i veçantë, nga i cili jetohej.

“Disa beduinë thanë: Ne kemi besuar!”¹

Këtë ia thanë beduinët felajmëruesit Muhammedit ﷺ Mirëpo, atëherë vetëm i përsëritën fjalët, të cilat e shprehin vërtetësinë e pejgamberësisë së tij. Ato nuk u përcollën me atë që udhëzoi se besimi në All-llahun ﷻ i ka lëvizur qeniet e tyre në reagim mbi pozitën e muslimanëve ndaj armiqëve apo ndaj raportit të armiqëve ndaj tyre. Këto fjalë nuk kanë inkuadruar vendosjen e fuqishme që ato, njëkohësisht të bëhen edhe pjesë përbërëse të vetë atyre, edhe udhëtregues në jetën private dhe publike.

Në pajtim me qëndrimin e tyre të këtyllë: pranimin e pejgamberisë së Muhammedit ﷺ që nuk është konfirmuar me asgjë që e përcjellë këtë pranim, as që ndihej ndonjë ndikim i tij, pasoi përgjigja kur'anore e cila përgënjeshtroi pohimet e tyre:

“Thuaj: Ju nuk keni besuar ende, por thuani: ne jemi dorëzuar, e ende nuk po hyn besimi në zemrat tuaja...”ⁱⁱ

Në fakt, ju nuk jeni dorëzuar plotësisht (nuk besoni Islamin e mirëfilltë), imani i mirëfilltë ende nuk është forcuar në zemrat tuaja. Ju vetëm para botës e keni shprehur fenë dhe kënaqësinë tuaj me Islamin, qoftë nga frika, siguria apo nga shkakuj tjetër. Sikur të thoshit se Islami është ideologjia juaj do të ishit të sinqertë. Për fjalët tuaja nuk ka vend, sepse imani konstruktiv posedon normat që kërkojnë flajime me jetë, pasuri personale, ose edhe njëherë edhe tjetër në bashku. Imani kërkon që feja mos tu bëhet në asnjë çast mjet për arritjen e pasurisë, të mirave dhe kënaqësive të kësaj bote.

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut, të dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të All-llahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetë.”ⁱⁱⁱ

Kjo është përgjigjja për njeriun që thotë se është besimtar, e në fakt nuk është. Misioni i imanit të vërtetë është i rëndë, sepse zë fill në abstenimin nga pasuria për grumbullimin e të cilës njerëzit rëndom synojnë dhe nxitojnë. Imani i mirëfilltë kërkon dhënien përparësi vdekjes ndaj jetës, kurse jeta është ajo që njeriu më së shumti e ruan dhe për ç’arsye rregullisht frikësohet.

Synimi i imanit të vërtetë është i gjatë nëse njeriut i është caktuar të jetojë, sepse rruga e All-llahut për të cilën njeriu duhet të luftojë nuk është rrugë pa vështirësi, sprova dhe kriza. Kjo është në të vërtetë, rruga që e përcjellin gjithnjë këto dukuri. Imani nuk është rrugë e disponimit dhe e kënaqësisë:

“Ju patjetër do të sprovoheni si në pasurinë tuaj, si në veten tuaj, madje do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është libri para jush, e edhe prej idhujtarëve, po në qoftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare.”^{iv}

Sprovimi me pasuri, jetë, me përjetimin e nënçmimit dhe humbjes nga armiku i fesë nuk është veçori vetëm për muslimanët e parë, për Muhammedin në radhë të parë, por ky është fati që, pa përjashtim, e karakterizon besimin në All-llahun ﷻ pa marrë parasysh në vendin dhe kohën.

Gjykimi përfundimtar për atë se kush sa është besimtar, pa marrë parasysh a është besimi i tij aktiv apo pasiv, edhe përkundër argumenteve të dukshme që e konfirmojnë këtë apo atë, i përket All-llahut në kuptim të ajetit kur’anor:

“Thuaj: “A ju ia bëni me dije All-llahut fenë tuaj (duke thënë: ne besuam), kur All-llahu është Ai që e di ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë dhe All-llahu është i dijshtëm për çdo send.”^v

Gjykimin për atë se kush ka poseduar iman, përfundimisht i lihet All-llahut, e kjo ka për qëllim që besimtari të përpiqet të bëhet i sinqertë dhe me imanin e tij të dëshirojë vetëm arritjen e kënaqësisë së All-llahut. Në këtë rast, imani do të jetë frytdhënës dhe do të sendërtohen rezultatet e tij të afërta dhe ato të mëvonshme.

Një nga fitimet e imanit në këtë botë është fuqia.

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu

për ta do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillë janë ata më të prishurit.”^{vi}

Fitimi nga imani në botën e ardhshme është kënaqësia e All-llahut dhe afërsia e Tij:

“Ndërsa, ata që besuan dhe bën vepra të mira, të tillët janë krijesa më e dobishme. Shpërblime për ta tek Zoti i tyre janë: vendet ne xhennete nëpër të cilët burojnë lumenj, e aty janë përgjithmonë, pakëputur. All-llahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata të kënaqur ndaj Tij. E kjo është për atë, që ia ka pasur dronë Zotit të vet.”^{vii}

Ai që brengoset për të patur besim të mirë në All-llahun ﷻ, nuk kërkon dëfrime të kësaj jete, as nuk pret që jeta t'i bëhet e lehtë. E vetmja që pret është zbatimi i premtimit të All-llahut ﷻ, që besimtarët e mirëfilltë t'i bëjë të deleguar të tij në tokë, dhe e dëshiron kënaqësinë e All-llahut ﷻ në botën e ardhshme. Këta janë ata që besojnë drejtë, nuk dyshojnë dhe luftojnë me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugën e All-llahut ﷻ

BESIMI NË ALL-LLAHUN - MBËSHTETJA E BESIMTARIT

Besimtari është përgjegjës për besimin e vet siç është përgjegjës edhe për jetën e vet.

Mbase kjo përgjegjësi ndaj besimit është më e madhe nga përgjegjësia ndaj jetës, duke e marrë parasysh se besimtari është i obliguar që të luftojë me pasuri, me jetë dhe me pasardhës në rrugën e All-llahut ﷻ për ideologjinë së cilës i përket. Kjo do të thotë se apelit për besim në All-llahun ﷻ, i cili është kodeksi i virtyteve pozitive, medoemos duhet t'ia përkushtojë veten dhe pasurinë e vet.

Mirëpo, nëse për shkak të besimit u ekspozohet kokëçarjeve në shoqërinë ku jeton, nuk guxon t'u nënshtrohet krizave, as nuk guxon të lejojë që t'i zhduket besimi. Thjesht, duhet të shpëtojë me ideologjinë, në mënyrë që t'i shpëtojë krizës së mundshme, sepse apeli në rrugën e All-llahut ﷻ nuk ka të bëjë më shumë me përfitimin e besimtarëve të rinj se sa me forcimin e besimit në All-llahun ﷻ te besimtarët të ekspozuar vështirësive.

“O robër të e Mi që besuat, toka Ime është e gjërë, pra vetëm Mua më adhuroni. Secili njeri do të shijojë vdekjen, e pastaj do të ktheheni tek Ne.”^{viii}

Kur'an'i e thërret besimtarin ta ruaj besimin e vet, qoftë edhe duke u shpërngulur për ta ruajtur këtë, t'i bëhet më e dashur se sa qëndrimi në vendin ku imani mund t'i rrezikohet dhe të vijë në pyetje.

Logjika kur'anore rreth kësaj çështjeje reduktohet në atë se tërë toka i përket All-llahut ﷻ dhe se ka vend për të gjithë besimtarët.

Përveç kësaj, çdo person patjetër duhet të vdes, këtu apo atje. Në sipërfaqen e tokës nuk ka asnjë kënd amshueshmërie që njeriu do të mund ta pranonte, duke kërkuar shpëtim në llogari të besimit, që do të thotë se kjo botë nuk është as faza e parë e as e fundit në jetën e njeriut dhe nuk

meriton kujdesin e atillë. Pas tij është jeta tjetër, e amshueshme, ku do të jetojë njeriu, qoftë në qetësi dhe në bollëk, apo duke vuajtur dhe larë mëkatet. Mënyra e jetës pas vdekjes është kushtëzuar me besimin në All-llahun ﷻ në këtë botë. Kërkohet besim i mirëfilltë me gjithë atë që e përcjellin. Atij, që nuk i intereson çështja e botës së ardhshme, mund të sillet ndaj besimit ngacmueshëm dhe të mos u përmbahet parimeve të tij.

All-llahu ﷻ premtan se rreziqet dhe krizat, të cilave do t'u ekspozohet imani i një besimtari, gjatë kohës do të zhduken plotësisht:

“S’ka dyshim se ata që e kundërshtojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, të tillët janë ndër më të poshtëruarit. All-llahu ka përcaktuar (shkruar në Levhi Mahvudh): “Unë dhe të dërguarit e Mi, pa tjetër do të ngadhnejmë!” All-llahu është i Fortë, Ngadhnyes.”^{ix}

Ata që All-llahun ﷻ dhe të Dërguarin e Tij i konsiderojnë armiq, i përbuzin parimet morale dhe konceptet teologjike. Ata e ngacmojnë besimin, i cili është burim i udhëzimit dhe i orientimit të sigurt, me kërkesën që ai të largohet nga jeta e njeriut, duke pohuar se ai nuk luan rolin e arsimuesit në shoqëri. Përpjekjet e këtilla manifestohen me krijimin e normave të reja që e rregullojnë jetën dhe sjelljen. Kështu, duke ua ndërruar atyre besimin në All-llahun ﷻ, njeriu zgjedh dhe pranon parime të reja të cilët e mundësojnë veprimtarinë e tij.

All-llahu ﷻ, në frymën e ajetit paraprak, u ka premtuar këtyre dy gjëra: e para, se do të përjetojnë përçmim, dhe e dyta, se do të pësojnë humbje, sepse All-llahu ﷻ me fuqinë dhe forcën e vet do t'i kundërvihet provokimeve të tyre.

Kjo edhe u përgjigjet, sepse dënimi për shkak të provokimit të All-llahut ﷻ dhe besimit në të është përçmim skajor, humbje dhe katastrofë për atë që këtë e provon.

Me këtë vepër, besimit të tij i ndihmohet edhe nga ana e All-llahut ﷻ

Kur njeriu kujdeset për njerëzishmërinë e vet, shqyrton natyrën e vështirësive dhe pengesave që i janë drejtuar kundër ideologjisë së tij, të cilat ai i duron me përpjekje të mëdha duke u orvatur që ta shpëtojë qoftë edhe me migrim nga vendi në vend, mburret tërë jetën me atë që e ka bërë në emër të gjërë më të dashur për të. Jeton në kujtimet plotë dritë, lavdi dhe trimëri sepse nuk është treguar i dobët në çastet e vështirësive dhe sprovave në të cilat amorali shfaqet në cilësi të titanit dhe provokimi forcohet në aspekt të tiranit. I tillë është ai që e mban vravashkën e së vërtetës, me të jeton dhe për të lufton. Për të e vërteta është dritë e udhëzimit, pa marrë parasysh se terri po shtohet, në te gjen impulsin dhe cakun e jetës.

Besimi konstruktiv në All-llahun ﷻ është udhëzim dhe shpresë, ai është jetë për atë që e kupton.

PERSONALITETI ËSHTË DOEMOS I LIRË NË ATË QË BESON

Islami garanton lirinë e besimit, jo vetëm për shkak se besimi nën presion është pa kurrfarë rezultatesh dhe dobish, por edhe për shkak se besimi me detyrim para së gjithash i kundërvihet natyrës së jetës në tokë dhe natyrës së vet njeriut.

Detyrimi është në kundërshtim me natyrën e jetës së njeriut, me natyrën çfarë edhe e dëshiron All-llahu ﷻ Ai dëshiron që kjo botë të bëhet arenë e së vërtetës dhe së keqes, deri sa nuk mbaron dhe nuk shndërrohet në trajtë tjetër që quhet ahiret.

Njëkohësisht me zanafillën e njeriut në tokë janë gjetur edhe dy gjëra: Udhëzimi i All-llahut ﷻ, misioni i të cilit ka përfunduar në periudhën ndërmjet Ademit عليه السلام dhe Muhammedit عليه السلام, e cila paraqet të vërtetën dhe udhërrëfimin, nga një anë, dhe me vullnetin e All-llahut ﷻ, mashtrimi i shejtanit në cilësi të përfaqësuesit të së keqes dhe jo të vlefshmes, nga ana tjetër.

“Përkujto kur Ne u thamë engjëjve: “Bëni sexhde Ademit!” (në shenjë përshëndetjeje) e ata i bën, me përjashtim të Iblisit. Ai tha: “A t’i bej sexhde atij që e krijove nga balta?” (mandej vazhdoi e) tha: “A e sheh (i tha Zotit) këtë që Ti e vlerësove mbi mua, nëse më lë të jetojë deri në ditën e kijametit, unë gjithsesi do t’i shfaros pasardhësit e tij, më përjashtim të një pakice”. (Zoti) tha: “Shko, e kush prej tyre vjen pas teje, shpërblimi juaj është xhehennemi, shpërblim i plotë!”^x

Del se All-llahu ﷻ i ka lejuar shejtanit, përfaqësuesit të amorales, t’i lajthojë njerëzit dhe t’ua zbukurojë të keqen. I është lejuar që misionin e tij rrënues ta vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit, deri në fillimin e periudhës së dytë të jetës së njeriut, deri në ahiret.

Thirrja e të dërguarit në të vërtetën dhe rrugën e drejtë është aktuale e do të zgjasë deri sa të ketë jetë, ndonëse dërgimi i tyre ka mbaruar me Muhammedin عليه السلام:

“Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë të shpëtuarit.”^{xi}

Ekzistimi i së vërtetës dhe së pavërtetës, njëkohësisht, në këtë botë, deri në Ditën e Gjykimit, porosinë lirinë e personalitetit në atë që beson sot dhe në të cilën do të besojë nesër. Sikur të mungojë kjo, përkatësisht sikur të gjithë njerëzit të besonin të vërtetën dhe ta ndiqnin rrugën e së mirës, kurse refuzojnë rrugën e së pavërtetës dhe të çlirohen nga mashtrimi i shejtanit, do të ishte e nevojshme dhe e domosdoshme të pushojë edhe jeta në tokë.

Sikur All-llahu ﷻ të dëshirojë fundin e konfliktit ndërmjet së vërtetës dhe së pavërtetës, do të zhdukej edhe kjo botë. Kuptimin e kësaj e gjejmë në ajetin:

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, që të gjithë ata që janë në tokë do t’i besonin...”^{xii}

Sikur të ishte jeta e atillë, do të ishte mbaruar, mirëpo, All-llahu ﷻ këtë nuk e ka dëshiruar dhe për këtë njerëzit janë të ndarë në disa që e ndjekin të vërtetën, e në disa që e ndjekin të pavërtetën.

Detyrimit të besimit në All-llahun ﷻ i kundërvihet edhe specificiteti i natyrës së njeriut:

“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.”^{xiii}

Atëherë All-llahu ﷻ natyrën e njeriut e ka dhuruar me aftësitë e kundërimit dhe njohjes:

“Ne e krijuam prej një uji të bashkëdyzuar për të sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë.”^{xiv}

Aftësia e tij që të kuptojë atë që e shoh dëgjon, përsiat, zë fill në vlerësimin e gjërave dhe në zgjidhjen e asaj që e konsideron korrekte dhe të mirë.

Kur njeriu detyrohet të besojë, kjo do të duhej të konsiderohej uzurpim i natyrës së tij, sepse kundërshtohet me karakteristikat me të cilat e ka shquar All-llahu me rastin e krijimit. Prandaj trajta negative e sentencës drejtuar Muhammedit ﷺ:

“A ti do t’i detyrosh njerëzit që të bëhen besimtarë?”^{xv}

nuk paraqet kurrfarë çudie as mohimin e rëndomtë të tentimit të detyrimit në besim, por ka të bëjë me secilin që kjo i bie në mend, pa marrë parasysh natyrën e lidhjes së tij me All-llahun ﷻ Përveç kësaj, as vetë All-llahu ﷻ nuk don që të gjithë njerëzit të besojnë. Vullneti i tij vjen në shprehje dhe ai është mbi çdo vullnet të njeriut.

Fakti i provës dhe vullneti në ideologji dhe në besim është i karakterit njerëzor-natyror, e pos kësaj edhe hyjnor-kozmik. Prandaj, orvatja e cilitdo që të gjithë njerëzit t’i kthejë nga një gjë, jo vetëm që në esencë është e pamundur, por në të njëjtën kohë udhëzon se ai që do të tentonte këtë nuk e njeh seleksionimin njerëzor, natyrën e njeriut dhe zhvillimin shoqëror. Kjo po ashtu flet se ai sikur edhe të ngjashmit, me të janë të ngeshëm, të preokupuar nga ata, që nuk ka kurrfarë dobie.

Detyrimi në fe, në cilëndo trajtë dhe formë, është orvatje jo e ndershme dhe johumane. Mirëpo, përparimi i njerëzimit në shkencë dhe aplikimi i saj në praksë, fatkeqësisht, ka qenë rruga e zgjerimit të detyrimit në fe, në vend që ta zhdukë atë. Kjo tregon gjenialitetin e vet, më të madh në krahasim me shkencën dhe zbatimin e saj në praktikë.

Prandaj, Kur’ani, kur e konfirmon lirinë e personalitetit në besim, siç flet ajeti:

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, që të gjithë ata që janë në tokë do t’i besonin. A ti do t’i detyrosh njerëzit që të bëhen besimtarë?”^{xvi}

dëshiron ta mësojë njerëzimin që në binarët dhe orientimin e vet ta nderojë njeriun dhe seleksionimin sipas natyrës së krijimit; kërkon nga shoqëria ta respektojë rrugën e jetesës së vet në rrethin e së mundshmes dhe nuk kalon atje ku do të ndeshet me ligjet natyrore dhe shoqërore dhe me të tjerat që e rregullojnë ekzistencën tokësore të njeriut.

Vullneti i All-llahut, gjatë krijimit të vet, kujdeset edhe për harmoninë e njeriut. Njeriu do t’i sendërtojë edhe parimet moralo-etike nëse jetën e ka në përputhje me vullnetin e All-llahut ﷻ. Ndërkaq, konflikti me të është gjykuar me shkatërrim, dhe jo vetëm që humbet orvatja e provokimit, por bëhet kundërvajtje dhe mëkat dhe lejohet shkatërrimi në fund, sepse fjala e All-llahut gjithnjë mbetet mbi çdo gjë.

Nëse përjashtohet detyrimi, nuk mbetet asgjë tjetër gjatë thirrjes në besim, pos dëshirës së fortë dhe bindjes në kufijtë e njerëzores, normales dhe bujares; kjo është ajo në çka thërret Kur’ani:

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.”^{xvii}

EPËRSIA E BESIMIT, E JO E BESIMTARIT

Natyra e njeriut është e karakterit dualist. Atë e përbëjnë arsyeja dhe gjykimi, nga njëra anë dhe instikti dhe pasioni nga ana tjetër.

Ajo është themel i njohjes dhe madhësisë, ajo është burim i rënies dhe i lajthitjes... Në të, së bashku janë shpirti i qetësuar, që synon kah e mira dhe keqja që ka prirje për të keqen.

Ajo njëkohësisht në vete bartë humanen dhe animalen.

Konstruksioni i këtillë i natyrës së njeriut e bën atë të hamendet ndërmjet së mirës dhe së keqes, madhësisë dhe poshtërsisë në veprime dhe sjellje.

Detyra e njeriut nuk është të shpejtojë, t'i zhdukë instiktet dhe në llogari të kësaj të bëhet i arsyeshëm dhe i urtë, por ta formojë dhe përgatisë personalitetin për jetë, si individ dhe lloj, pos nëse nuk dëshirohet vdekja e tij.

Njeriu nuk abstenon nga solidariteti me arsye, në mënyrë që t'u kundërvihet pasioneve të cilat janë shumë të fuqishme nga arsyeja, sepse nga fillimi janë të përgatitur për aktivitetin e caktuar dhe më shpejtë zhvillohen se arsyeja dhe njohja.

Detyra e njeriut është ta vendosë baraspeshën ndërmjet këtyre dy shfaqjeve në vete; duhet të jetë tepër i drejtë dhe të pengojë që njëra të ngadhënjë mbi tjetrën, që mos t'u jep mundësi pasioneve që ta mposhtin arsyen, e cila është më e dobët se ato. Për këtë arsye, në kuptim të

rivënies së drejtësisë së kërkuar, është obliguar të ofrojë mundësi të madhe zhvillimit të arsyes në mënyrë që të forcohet.

Por kush i garanton individit se do ta rivendosë baraspeshën e kërkuar në qenien e vet ose cilës do gjë tjetër me natyrë komplekse.

Njeriu, në analogji me natyrën e vet dualistike, hamendet ndërmjet dy skajshmërive, nganjëherë anon kah epihet dhe instiketet, nga shkaku se kjo është ana e tij më e fuqishme e cila e tërheq nga vetja. Me këtë rast vjen në shprehje domosdoshmëria e faktorit të baraspeshës.

Thuhet se përvoja njerëzore, e cila gjatë historisë së gjatë është shndërruar në të drejtë, tradita dhe ligje, mundet, në suaza të njohjes dhe edukatës, që të shpjerë njerëzimin drejt normave të moralit të shëndoshë të cilave do t'u përmbahet në sjellje dhe kështu ta ruaj baraspeshën ndërmjet arsyes dhe instiktit.

Në bazë të kësaj shtrohet pyetja:

1. Ç'e garanton korrektësinë e këtyre pikëpamjeve, traditave dhe ligjeve, të cilat janë po ashtu pjesë përbërëse e arsyes dhe instiktit, për ruajtjen e baraspeshës së kërkuar gjatë gjeneratave?
2. Ç'e siguron suksesin e tyre në arritjen, përkatësisht në baraspeshën për të cilën është fjala, nëse konsiderojmë se normat e larta janë të sakta?

Kur'ani i shton natyrës dualistike të krijimit të njeriut edhe gjënë e tretë, e cila duhet të përfilllet. Ky është çelësi i baraspeshës dhe drejtësisë ndërmjet arsyes dhe pasioneve, kjo është zemra. Ai për të thotë:

“All-llahu ju nxorri nga barqet e nënave tuaja (si foshnje), e ju nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.”^{xviii}

Kur’ani i jep shenjë specifitetit të natyrës së njeriut dhe nuk e gjen atë vetëm në arsye, por e shikon së bashku me shqisat e të dëgjuarit dhe të pamurit dhe në vet zemrën.

Sa u përket pasioneve, ajeti i sipërm nuk i përmend nga shkakun se ata janë simbol i animales, përbërës i përbashkët i shtazës dhe njeriut, kurse këtu fjala është për begatinë e All-llahut, diturinë të cilën ia ka dhuruar njeriut. Dituria është karakteristike me të cilën dallohet vetëm njeriu, për arsye të aspektit të tij njerëzor, e jo animal.

Detyra e arsyes është që të njohë dhe të gjykojë. Zemra është vendi i besimit në All-llahun ﷻ, që ta ruaj baraspeshën ndërmjet dy natyrave të kundërta të njeriut, arsyes dhe instiktit. Besimi në fuqinë e vet e ktheu njeriun kah udhëzimi, Kur’ani; ai është mbështetës i përhershëm për arsyen dhe njohjen gjatë pjekjes, sikur është ndihmues gjatë mbajtjes së instikteve dhe mbetjes së tyre në jetë. Ndihma e besimit, zhvillimit të arsyes, në aspektin pozitiv, përbëhet nga edukimi i instiktit që mos të shndërrohet në epsh dhe mos të zotërojnë me të gjitha veprimet e njeriut. Në këtë mënyrë krijohet atmosferë e volitshme edhe për zhvillim të suksesshëm intelektual.

Së këndejmi, personaliteti që beson në All-llahun ﷻ jeton me jetë të vërtetë natyrore. Ky është njeri i lirë dhe fisnik. Prandaj besimi është vlere e vetme e besimtarit që vjen në shprehje në sjelljen e tij pozitive dhe në baraspeshën e natyrës së tij dualistike, kurse vetë besimtari nuk paraqet kurrfarë vlere për fenë:

“Ata të shprehin ty mirënjohës (ta përmendin) që u bën muslimanë. Thuaj: -Pranimin tuaj të fesë Islame mos ma njihni (mos ma përmendni) mua, por nëse jeni të sinqertë All-llahu juve ju bëri mirë, kur ju udhëzoi për besim.”^{xix}

BESIMTARI I DOBËT DHE I FUQISHËM

Dallimet ndër individët në sferën e natyrës njerëzore (në njohje, pjekuri, energji, vendosmëri) janë ekzistuese dhe reale. Madje edhe emocionet, të nxitura nga motivi i njëjtë, dallojnë nga njëri person te tjetri. Edhe të perceptuarit njerëzor të gjërave dhe gjykimi për to nuk janë te të gjithë në shkallën e njëjtë të precizitetit. Rasti i këtillë ka të bëjë edhe me vullnetin në çështjen e marrjes së qëndrimeve të ndryshme ndaj disa rasteve dhe dukurive.

D.m.th. karakteristikat e veçanta, të cilat janë të ndryshme sipas specificiteteve të veta, kontribuojnë që njeriu të përcaktohet për ndonjë parim apo ideologji.

Në këtë pyetje nuk ka kurrfarë dallimi as në lojalitetin e Islamit. Ka besimtar, përkatësia e të cilit në Islam është aq e thellë, e përshkuar me mësimin Islam që veten dhe pasurinë e tij e vë në disponim për sendërtimin e parimeve Islame. Në anën tjetër është sërish besimtari, imani i të cilit është formalitet i pastër. Imani i këtillë nuk lë kurrfarë gjurmash në personalitetin, pasurinë e tij dhe në kënaqësitë e kësaj bote. I tilli ka zgjedhur ndërmjet imanit nga një anë, dhe egoizmit dhe

begatisë, në anën tjetër. Rruga që e ndjek tregon dobësinë e besimit të tij dhe rangimin e të mirave të kësaj bote në plan të parë.

Lloji i parë i besimtarëve të zënë në gojë janë të fuqishëm në besimin, ekzistencën dhe aksionet e veta në rrugën e besimit konstruktiv, në rrugën e apelit të shoqërisë që beson, shoqërisë që në themel është e pjekur dhe kompakte.

Lloji i dytë nganjëherë është barrë për shoqërinë, apo sipas parashtrimit më të saktë, i është e panjohur e mira e përgjithshme. Ekzistimi i këtij lloji besimtarësh është i lidhur vetëm me interesin personal dhe është për t'u frikësuar që mos të shndërrohet në hipokrizi, kurse edhe nga ana moralo-etike është e papranueshme, sepse paraqet rrezik për sigurinë e shoqërisë dhe thirrjen ideologjike. Ky është rrezik i madh për jetën e shoqërisë, sepse shërbehet me fuqinë e mashtrimit dhe shtirjes.

Vetë Kur'ani e shtron dallimin ndërmjet besimtarit të fortë dhe të dobët dhe vendin e njërit dhe tjetrit tek All-llahu ﷻ:

“A mos e konsideruat dhënien e ujit haxhinjve dhe kujdestarinë ndaj xhamisë së shenjtë, si besimin e atij që i besoi All-llahut dhe ditës së fundit dhe që luftoi në rrugën e All-llahut? Jo, ato nuk janë të barabarta te All-llahu. Popullin mizor All-llahu nuk e vë në rrugë të drejtë.”^{xx}

Me anë të stilit pyetësor të fjalisë mohohet barabarësia mes besimtarit që kujdeset për haxhinjtë dhe Bejtullahun dhe atij që beson All-llahun ﷻ, Ditën e Gjykimit, dhe pos kësaj lufton në rrugën e All-llahut. Lufta në rrugën e All-llahut, d.m.th. durimi i vështirësive dhe sakrificave gjatë thirrjes në Islam, zgjerimin e tij dhe vigjëlinit të përhershëm që të mbetet i fortë dhe i fuqishëm, kjo në

fakt është lirimi nga egoizmi dhe shtytjet e ulëta të epsheve. Me fjalë të tjera, kjo d.m.th. të jetojmë në harmoni të detyrave dhe obligimeve që nga ne i kërkon besimi, dhe të cilat nganjëherë kërkojnë vetëmohim ose na shpiejnë në vdekje... Shërbimet ndaj haxhinjve në Ka'be janë aktivitete të rëndomta që nuk kërkojnë sakrificë në pasuri, jetë ose në pasardhës. Kur'ani e konfirmon dallimin e tyre që pas pyetjes së shtruar sjell gjykimin:

“Ata të cilët besuan, migruan dhe luftuan me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e All-llahut, ata kanë pozitë më të lartë te All-llahu dhe vetëm ata janë fatlumë.”^{xxi}

Dhënia ujë haxhinjve dhe ruajtja e Ka'bes janë për Kur'anin, shembull i aksionit të besimtarëve më të dobët, deri sa hixhreti dhe xihadi në rrugën e All-llahut me jetë dhe pasuri janë karakteristika të besimtarëve më të mëdhenj. Ky është shembull nga realiteti i shoqërisë së parë muslimane, por lirisht dhe në tërësi mund të bëhet dallimi, të bëhet rregull i përgjithshëm, ndërmjet disa aksioneve dhe t'i atribuohet njërit grup. Kjo është e mundur në bazë të asaj që kemi përmendur se besimtari i fuqishëm është ai që është i përshkruar aq shumë me besimin në All-llahun ﷻ dhe me ftesën që veten dhe pasurinë e vet ta vë në disponim për sendërtimin e ideologjisë së cilës i përket, deri sa besimtari më i dobët është ai që është në mes ose hamendet ndërmjet asaj çka ofron kjo botë dhe sakrificave që i kërkon besimi konstruktiv të bëhen në emër të saj.

Ai nganjëherë i jep epërsi vetes dhe kësaj bote ndaj nevojave të fesë, dhe bëhet hipokrit, ashtu që nuk dihet qartë se cilës anë i takon, anës së ëndjeve të veta ose përkatësisë së mirfilltë të ideologjisë së vet.

Rezulton se besimtari i fuqishëm është më i mirë se i dobëti, dhe se fuqia e shoqërisë bëhet më e madhe me të fuqishmit, ndërsa bie me të dobët.

Nga kjo, po ashtu, përfundojmë se nuk është çudi që hipokriti i shfrytëzon begatitë e kësaj bote, derisa besimtari i mirëfilltë privohet nga këto. Ky privim është produkt i zgjidhjes së tij të pavarur dhe kjo për atë paraqet kënaqësi të vërtetë. Ndikimi i këtij lloji të kënaqësisë për besimtarin e vërtetë sigurisht është më i madh se pasojat e jetës komode mbi hipokritin.

Ç'PRITET NGA BESIMTARI NË IDEOLOGJINË DHE MORALIN E TIJ

Besimtari ka lidhje me Krijuesin e vet, me të afërmit, shoqërinë dhe bashkësinë, me anëtarët e së cilës jeton bashkërisht.

Lidhja e tij me All-llahun ﷻ duhet të jetë e sinqertë dhe e pastër, ajo duhet të jetë pa i përshkruar shok All-llahut, në lutje respektimit të nënshtrimit dhe vetëm Atë të vetmin ta ngrenë në apogje të gjithëkzistueses.

“Thuaj: -Ejani t’ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloj Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send...”^{xxii}

Përshkrimi shok All-llahut ﷻ nuk do të thotë zvogëlim i madhësisë së Krijuesit, por nënçmim i dinjitetit të njeriut që e bën këtë. Ai që e krahason All-llahun ﷻ me krijesat tjera, njëkohësisht e ngre ndonjë krijesë në shkallën e All-llahut ﷻ, i barazon vetitë e Krijuesit me ato të krijesave të Tijja, e barazon Sunduesin me ata që janë të sunduar, Apsolutin me ata që janë të kufizuar. Atëherë atij që shërbehet me këtë logjikë i lejohet t'i adhurojë edhe dikë nga njerëzit të barabartë me veten, madje edhe gjëra që janë më të ulëta përka vlera edhe nga vetë ai, duke e zvogëluar në këtë mënyrë dinjitetin e vet njerëzor. I tilli nuk është besimtar të cilin e do All-llahu ﷻ Besimtari, të cilin e kërkon All-llahu ﷻ e di vlerën e krijesave në ekzistencën e përgjithshme, si dhe vlerën, të drejtën dhe detyrën e vet.

Mospërshkrimi shok All-llahut ﷻ është veçori e njerëzishmërisë së vërtetë, e cila nuk mposhtet, e as që i mohon veçoritë e saja.

Lidhja e besimtarit me ata që i janë më të afërm përbëhet në sjelljen e njerëzishme dhe fisnike qoftë ndaj prindërve, fëmijëve, miqve...

“Adhuroni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqiu të afërt, fqiu të largët, shokut pranë vetes, udhëtarit të largët dhe robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”^{xxiii}

Prindërit, pos asaj që ndikimi i tyre te i biri është i madh, ata në raport me të birin, jetojnë periudhën lamtumirëse të jetës së vet. Së andejmi nga ana e tij duhet t'ua sigurojë, para së gjithash, jo vetëm kujdesin material, por edhe nderimin dhe kujdesin e nevojshëm, pa marrë parasysh pozitat e ndryshme shoqërore që i zënë. Kjo është shenjë se janë të respektuar, se u plotësohen

dëshirat dhe se nuk u nënçmohen ndjenjat. Ndërkaq, gjatë pranimit të sugjerimeve prindërore në punët birërore, i jepet përparësi, sipas traditës Islame, asaj që mbështetet në bindjen reale, duke i respektuar rrethanat dhe rastet ekzistuese.

Prindërit ndaj fëmijëve duhet të jenë zemërgjerë, ashtu si edhe ndaj atyre që janë të gjallë, dhe ndaj atyre që janë në rrugë të lindin. Nuk guxojnë ta konsiderojnë barrë atë që e investojnë dhe flijojnë për ta, sepse ata janë të paaftë, të varur dhe nuk janë në gjendje të ndajnë me prindërit vështirësitë e jetës.

Kur Kur'ani ndalon mbytjen e fëmijëve, në ç'drejtim disa kanë anuar, duke u arsyetuar se ata u janë barrë, ai thërret prindërit që t'i largohen kësaj, sepse All-llahu ﷻ i furnizon edhe këto edhe ata. Analogjikisht me këtë, Kur'ani ndalon edhe kryerjen e terrorit ndaj tyre, abstenimin ndaj tyre, blasfeminë, ngushtimin e mundësive të tyre dhe perceptimin se janë barrë, objekte dhe gjësende të panevojshme. Krejt kjo pengon zhvillimin e tyre normal dhe formon tek ata kompleksin e alienacionit.

Besimtari i mirëfilltë është optimist. Shpirti i tij është i mbushur me shpresë në All-llahun ﷻ dhe mbështetjen në Të, në çdo aksion. Ndoth që njeriu, atë që mbase do ta shpenzonte për fëmijën, ta shpenzojë për sëmundjen që e goditë, e çfarë është dallimi ndërmjet investimit në sëmundje e cila dobëson dhe molis dhe investimit në pasardhës që jetojnë dhe përparojnë.

Sa u përket lidhjeve tjera të besimtarit, ato manifestohen kryesisht në katër gjëra:

1. Shenjtëria e jetës:

“...mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend!...”^{xxiv}

2. Shenjtëria e pasurisë:

“Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë, (mund t’i afroheni) vetëm në mënyrën më të mirë, zbatoni me drejtësi masën dhe peshojën. Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij...”^{xxxv}

Këto janë pacenueshmëritë të cilat nuk guxojnë të përdhosen as të thyhen, sepse në mbrojtjen e tyre është pranimi i ekzistencës së tjetrit dhe zgjerimi i suazave të së drejtës së tij të bashkimit në jetën publike. Këto shenjtëri janë shenjë, se ai që i ruan është njeriu me të cilin nuk sundojnë epshet në veprime. Ai nuk ka rënë nën ndikimin e egoizmit, as nën ndonjë faktor të sprovës në raportet e tij me të tjerët, ndonëse rrethanat ndonjëherë kërkojnë të qëndrojnë anash çdo gjëje që ndodh në skenën jetësore. Bonjaku që posedon pasuri, është i paaftë t’u kundërvihet atyre që janë më të fortë nëse dëshirojnë të luajnë me pasurinë e tij. Nevoja e detyron të rrezikuarin social që të mos masë drejt kur matë apo peshon. Dëshmitari po ashtu gjen shumë shkaqe të dëshmojë në dobi të të afërmit nëse ky është përzier në ndonjë proces gjyqësor. Ndonjëherë njëra nga palët e kontratës së nënshkruar gjen arsyttime të ndryshme që të shkel këtë kontratë.

Ajeti i sipërm, kur i precizon lidhjet e besimtarit me të tjerët, qoftë në familje, në bashkësinë e ngushtë apo të gjerë, ka për qëllim vetëm t’i mundësojë njeriut të bëhet element pozitiv në ndërtimin e shoqërisë kompakte, që në vlerësimin e vet dhe në vlerësimin e të tjerëve të bëhet njeri në kuptimin e plotë të fjalës, i atillë çfarë e ka krijuar All-llahu ﷻ dhe të jetojë jetë të lirë dhe të sinqertë. Së andejmi përfundimi i ajetit të theksuar është në kuptim të fjalëve:

“Dhe se kjo është rruga Ime e drejtë, pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që ë ruheni.”^{xxvi}

BESIMTARI DHE FJALA E DHËNË

Fjala e dhënë (besimi) nuk përbëhet vetëm nga të ruajturit e gjësë së besuar. Ajo manifestohet në aspekte të ndryshme: material, emotiv, abstrakt etj.

Fjala e dhënë në të vërtetë, përbëhet nga plotësimi i obligimeve të cilat besimtari i ka ndaj vetvetes, përgjegjësisë në vendin e punës, ndarjes së drejtësisë në mënyrë të drejtë, plotësimi i kontratës dhe premtimit të sinqertë gjatë këshillimit, kujdesit ndaj familjes etj.

Kjo në fakt është pranimi i të gjitha obligimeve të cilat me vete i sjell marrja e sinqertë e besimit konstruktiv në All-llahun ﷻ ku Ai urdhëron:

“...që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve...”^{xxvii}

ku ka për qëllim obligimet e ndryshme që duhet plotësuar dhe aplikimin e të cilëve e përcjell këmbimi reciprok dhe forcimi i besimit ndër besimtarët. Këtu ai nuk aludon vetëm në anën materiale të këtij atributi i cili është i njohur me emrin “depozitim” (ruajtje)”. E pastaj, kur në vazhdim të ajetit urdhëron drejtësinë:

“...ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve...”^{xxviii}

dëshiron të tërheqë vërejtjen në rëndësinë e saj në jetën e shoqërisë, nëse do ta zbatonte.

Pasi që plotësimi i fjalës në të gjitha trajtat e saj është themel i sigurisë së besimtarit, ajo njëkohësisht është edhe parulla e ruajtjes së interesave të përgjithshme. Fjala e dhënë e cila inspiron që të plotësohen të gjitha obligimet në raport me anëtarët e shoqërisë, është besim origjinal, i cili mbanë kompabilitetin dhe lirinë e plotë të jetës në shoqëri dhe provimin e vërtetë të normave në të cilat zë fill. Së këndejmi nuk ka asgjë më të vlefshme se besimi i ndërsjell i anëtarëve të shoqërisë, qoftë kjo në paraqitjet e sinqerta ndaj njëri tjetrit, vëllazërinë, ndihmën dh dashurinë reciproke.

Besimtari i plotëson obligimet e besuara pa hamendje dhe nuk ka nevojë për kontrollor që do ta përcjellë çdo hap të tij. Ju qaset detyrave i furnizuar me ndjenjat, e thella të obligimit dhe përgjegjësisë, i përshkuar me liri të plotë, lirinë e pranimit dhe kryerjes, lirinë e detyrës dhe obligimit. Vetëm në këtë mënyrë ai mundet ta arrijë shkallën që i përgjigjet natyrës së tij të veçant me të cilën All-llahu ﷻ e dhuroi njeriun me rastin e krijimit. Për shkak të sendërtimit të humanitetit të plotë, një nga rrugët e të cilit është besimi, ajeti i theksuar përfundon:

“Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.”^{xxix}

Sa e madhe dhe e vlefshme është ajo që është porositur në ajetin e theksuar. Në një ajet tjetër përmendet besimi si atribut i domosdoshëm për besimtarin, atribut që duhet patjetër ta përmbush jetën e tij. All-llahu ﷻ duke i ekspozuar veçoritë e besimtarëve të vërtetë thotë:

“Dhe të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë.”^{xxx}

Premtimet e plotësuara d.m.th. aspekt i besimit. Kur’ani me këtë rast, sikur edhe më parë, shprehet në trajtën e shumësit në fjalën “besim-dhënia e fjalës” dhe konfirmon si ai ka forma të shumëllojta se përbëhet nga obligimet e përgjithshme dhe të veçanta dhe detyrat e shumënumërta të cilat besimtari i pranon me vullnetin e vet të lirë dhe me personalitetin komplet human, i cili është thellë i përshkruar me besimin në All-llahun ﷻ. Rezultatet e kësaj shihen nëpërmjet lidhjeve të nduarnduarta të individit me tjetrin.

Para mbarimit të ajetit të theksuar më parë, pasi që nga besimtari kërkohet besimi dhe aplikimi i drejtësisë, All-llahu ﷻ thotë: “All-llahu çdo gjë dëgjon dhe sheh”, duke përkujtuar se Ai është dëshmitar i asaj që besimtari flet kur gjykohet dhe vëzhgues i çdo veprë të tij. Në të tërhequrit e vërejtjes në atributet e All-llahut të dëgjimit dhe të pamurit qëndron domethënia e kryerjes së vetëdijshme të besimtarit të asaj që kërkohet nga ai, kurse lënia e asaj që i ndalohet. Në këtë është fshehtësia e vetkontrollit në sjellje dhe barabartësinë e të gjithë besimtarëve-se të gjithë janë kujdestarë (barinj) dhe se të gjithë janë përgjegjës për kopenë e vet, dhe më në fund, se nuk është e novojsme ta kontrollojnë njëri tjetrin.

BESIMTARI DHE RESPEKTI

Që marrëdhëniet ndërmjet besimtarëve të mbeten të forta, ato reciprokisht nuk guxojnë të nënçmohen, as të ofendohen me atë çka e cungon dinjitetin njerëzor. Njëri grup nuk guxon ta nënçmojë tjetrin.

Këto dhe shfaqjet e ngjashme janë pasoja të vetbindshmërisë, egoizmit dhe urrejtjes.

Islami nuk ndalon që muslimanët të ndahen në mendime, duke e marrë parasysh se kjo është gjë që zë fill në dallimet reale individuale, dhe mospajtimi në mendim edhe përveç kësaj nuk shpie kah çarjet. Përkundrazi, mospajtimet rriten në kompaktësi dhe unitet, përkundër orvatjeve të teorive shoqërore, bashkëkohore të cilat e rekomandojnë dhe ndihmojnë çarjet në shoqëritë moderne të njohura me emrin “kompleksi social”. Por, kur dallimet në mendim shpiejnë deri në konflikte, Islami urdhëron për t’iu drejtuar Kur’anit dhe Hadithit dhe aplikimin e qëndrimeve në këto dy burime, që të shmangen të përçarjet. Kërkon nga ata që janë ndarë ta pranojnë njërin nga burimet ose të dytë së bashku në kualifikimin e asaj për ç’arsye janë ndarë:

“O ju që besuat, nënshtrojueni All-llahut, nënshtrojueni të dërguarit dhe përgjegjësve nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, drejtojueni All-llahut dhe të Dërguarit po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit!”^{xxxix}

Islami i thërret besimtarët e vet t’i kthehen Kur’anit dhe Sunnetit, kur mospajtimi në mendim kalon në konflikt, dhe kështu ai rigorozisht ka kujdes mbi unitetin dhe kompaktësin e tyre. Me të njëjtin synim ai ndalon përqeshjen dhe përçmimin në kontaktet reciproke. Sipas All-llahut ﷻ,

këto attribute negative nuk munden kurrësi të dalin nga bujari dhe toleranti i cili me të tjerët ndan dhe dhimbset. Në nivelin e dukurive të përmendura janë edhe blasfemia, akuzimi jo i bazuar, emërtimi me emra të shëmtuar të cilët ndoshta i përgjigjen gjendjes së tashme apo të përparshme të bartësve të tyre, p. sh. besimtari që quhet i qalë, i verbër, i zi, e qorton dikë për shkak të të kaluarës së tij të keqe për çka ai vërtetë është dëshmuar. Për gjithë këtë Kur’ani thotë:

“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë.”^{xxxii}

Kur’ani numron tri lloje shqetësimesh, tri format më të rënda, me të cilat besimtari mund ta nxisë tjetrin me të cilin jeton së bashku. Këto attribute janë më të shëmtuara për shkak se rrjedhin nga besimtari i cili duhet të jetë mjaft i edukuar dhe i cili nuk guxon të lejojë që sjelljen ta përcjellë egoizmi dhe urrejtja. Pastaj, ato mund t’i drejtohen besimtarit kur ky është në shoqëri me tjetrin, i cili mbase është më human, më i gatshëm për aksion dhe më i afërt All-llahut ﷻ se ai, dhe edhe nga kjo janë nënçmim i madh. Këto attribute janë:

1. Përqeshja dhe nënçmimi i tjetrit;
2. Ofendimi me sharje dhe akuza të pabaza dhe;
3. Emërtimi me emra përqeshës të cilat përbuzin atë, të cilit i drejtohen.

Paprekshmëria e muslimanit nuk respektohet ç’prej se bota Islame është ndarë në grupe më të vogla. Është bërë normale ajo që Islami e ka ndaluar. Gjendja e raporteve ndër këto grupet në

rrethanat bashkëkohore mohon se ato kanë çfarëdo lidhje me Islamin dhe konceptimin e tij. Njëra tjetrën e nënçmon, pabazë e akuzon dhe ia atribuon atributet të cilat në opinion kanë marrë formën e mosbesimit dhe përgënjeshtimit.

Konceptimet etike të Islamit janë konceptime të moralit të lartë dhe humanitetit skajor. I shërbejnë vetëm së mirës, të njerëzishmes pa dallim në kohë dhe në gjeneratë. Prandaj, çdo gjë që e pason afirmimin e tyre paraqet një hap mbrapa në rrugën e sendërtimit të humanitetit të mirëfilltë.

BESIMTARI DHE GRINDJA

Besimtarët janë të afërm me njëri tjetrin. Ata janë vëllezër, pa marrë parasysh vendin ku jetojnë. Dallimet në gjuhë, komb dh ngjyrë të lëkurës nuk janë faktorë që i ndajnë, siç nuk janë kështu as malet, lumenjtë, shkretëtirat, dhe detet. Ndërmjet vete janë të lidhur me lidhjen e cila u është e përbashkët, e kjo është besimi në All-llahun ﷻ dhe në të dërguarin e Tij Muhammedin ﷺ. Për ta kjo është kriteri mbi çështjen për të cilën ndahen:

“Për çdo send që nuk pajtoheni, gjykimi për të është te All-llahu.”^{xxxiii}

Dhe kjo është ajo së cilës po i kthehen kur dallimi në mendim shpie deri në grindje:

“O ju që besuat, nënshtroni All-llahut, nënshtroni të dërguarit dhe përgjegjësve nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, drejtojeni All-llahut dhe të Dërguarit po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.”^{xxxiv}

Këto janë marrëdhëniet reciproke të besimtarit ashtu si i paraqet Kur’ani. Ata për njëri tjetrin janë pasqyrë, ku secili i sheh lëshimet e veta.

Nëse disa vie deri te kontesti apo te konflikti ndërmjet dy grupeve të besimtarëve, është detyrë e muslimanëve të tjerë të intervenojnë, ta zgjidhin situatën e krijuar dhe ta vendosin qetësinë dhe harmoninë, sepse Kur’ani këtë e kërkon prej tyre:

“Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, pajtoni ata!”^{xxxv}

Përfundojmë se Kur’ani të gjithë besimtarët i fton të intervenojnë në rast grindjeje dhe se kjo nuk është detyrë e grupi të veçantë.

Mirëpo, nëse njëra nga palët e shkelë kontratën ose nuk i përgjigjet apelit për paqe dhe vazhdon armiqësinë, atëherë është detyrë e të gjithë muslimanëve, pa përjashtim, t’i qërojnë hesapet me palën e cila tregohet si agresor dhe tiran dhe të jenë këmbëngulës në këtë deri sa edhe ajo palë nuk kthehet në atë në çka i ka ftuar Kur’ani, e kjo është vendosja e vëllazërimit Islam në vend të grindjes dhe përçarjes:

“Në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me padrejtësi, derisa t’i bindet udhëzimit të All-llahut!”^{xxxvi}

Nëse vëllazëria fiton, kurse konflikti dhe armiqësia flaken midis vëllezërve të fesë, është detyrë e besimtarëve që t'i vënë kushtet e paqes në mënyrë që drejtësia plotësisht të sendërtohet. Këtë e kërkon All-llahu dhe me këtë është i kënaqur. Përveç kësaj, kjo është rivendosja e paqes ndër palët të cilat me fe janë të barazuara. Kjo është ajo për çka jep shenjë edhe Kur'ani:

“Në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me padrejtësi, derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse kthehen, atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, mbajeni drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtën. S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe keni frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar!”^{xxxvii}

Intervenimi gjatë pengimit të konflikteve lokale dhe vendosja e harmonisë dhe dashurisë midis të grindurve brenda shoqërisë Islame është rrugë e fesë. Kjo është ajo çka kërkon Kur'ani, sepse problemet e një grupi besimtarësh janë probleme të të gjithëve, pa marrë parasysh largësinë që i ndan, pa marrë parasysh dallimet në gjuhë, ngjyrën e lëkurës apo kombin. Besimtarët ndërmjet vete nuk dijnë për problemin e “përzierjes në punët e huaja”, sepse nuk janë të huaj për njëri tjetrin. Mirëpo, përzierja e armikut në punët e tyre ka bërë që të ndryshojnë raportet mes vete, që afërsinë dhe pavarësinë e vet t'ia adaptojnë këtij armiku. Kështu ndërmjet vete janë bërë të huaj dhe besojnë në pikëpamjet dhe normat që ua ka imponuar armiku, i cili është përzier në punët e tyre. Janë krijuar rrethojat, pengesat dhe kufijt jo vetëm gjeografik, gjuhësor dhe nacional, por madje edhe ideologjik dhe fraksional brenda shoqërisë Islame, e cila është ndarë në shtete të pavarura politike dhe çdonjëri prej tyre ka vendosur për “mospërzierje në çështjet e brendshme të tjetrit” dhe parimin e “seperatizmit”. Kështu armiku i muslimanëve arriti që ata ta lënë atë më të vlefshmen: kompaktësinë reciproke të cilën ua urdhëron feja në dominim, ndihmesë dhe dashuri.

Këtij armiku, pa marrë parasysh që ai i shkelë kufijt që i ka caktuar All-llahu ﷻ dhe i Dërguari i Tij, i ka shkuar për dore më shumë se ta marrë pushtetin e besimtarëve mbi vete. Kjo është çështje, për të cilën Kur’ani mëson se nuk pajtohet me atributet e fesë konstruktive:

“Njerëzit, që besojnë në All-llahun dhe në botën tjetër, nuk duhet të jenë në dashuri me ata, që All-llahut dhe të Dërguarit të Tij i kundërvihen, qoftë ata të jenë babatë e tyre, apo fëmijët e tyre, apo vëllezërit e tyre, apo kushërinjt e tyre.” (El-Muxhadele, 22).

Duke numëruar kështu, Kur’ani shkon deri në brezin e fundit të më të afërmve në familje dhe kategorikisht e ndalon këtë duke folur:

“Besimtarët, kur ka besimtarë, mos të shoqërohen me mosbesimtarët! E ai që këtë e bën, nuk duhet të shpresojë kurfarë të mire nga All-llahu; vetëm kështu bëni, që prej tyre të mbroheni.” (Ali-Imran, 28).

Duke iu falënderuar parimeve të seperatizmit dhe mospërzierjes në punët e brendshme të të tjerëve, kurse pas pavarësimit të vërtetë politik të disa grupeve të besimtarëve, janë shtuar edhe problemet e tyre dhe jeta është bërë më e kompletuar ashtu që edhe pavarësia e tyre politike është në hije të raportit të tij që e dëshiron dobësinë e tyre dhe asaj çka fsheh zemra e tij “e madhe”. Muslimanë të dobët u bëtë me pavarësinë, e cila zë fill në parimin e mospërzierjes në çështjet e brendshme të tjetrit. Besimtari sot në qetësi e shikon vëllain e vet se si e dënon apo e mbytë dora e armikut të përbashkët, dhe jo vetëm kjo, por e ndihmon luftën duke e vështruar fituesin me ngazëllim, dhe duke e nënçmuar të humburin. Muslimanët kanë probleme të karakterit ekonomik ekzistencial, politik dhe mbrojtës dhe zgjidhja e tyre gjendet në heqjen e kufijve dhe pengesave që

e ndajnë botën muslimane, sepse asnjë shtet Islam nuk ka mundësi që individualisht t'i zgjidh as problemet e veta lokale.

Përfundimisht, a do t'i kthehen muslimanët vëllazërisë, dominimit, solidaritetit, këshillimit reciprok dhe marrëveshjes gjatë zgjidhjes së problemeve me të cilat janë ndeshur. A po e dijnë se armiku i përbashkët ua ka imponuar parimin e seperatizmit dhe ua ka bërë të dashur pavarësinë, qoftë ajo rajonale, fisnore, ideologjike, gjuhësore apo nacionale, duke iu hakmarrur, duke u kujdesur që të mbeten të dobët, duke e shfrytëzuar gjatë kësaj pasurinë dhe fuqinë e tyre? A po gjejnë në Kur'an parime të cilat do ta ndërtojnë sistemin e jetës, i cili u garanton siguri, stabilitet, lavdi dhe fuqi!

BESIMTARI DHE PACENUESHMËRIA PERSONALE

Sot ekzistojnë dy teori në lidhje me pozitën e njeriut në shoqëri ku jeton. Ato janë plotësisht kundërshtuese. Njëra nisat nga botëkuptimi se njeriu është i pavarur dhe se ka lidhje me të tjerët nëpërmjet ligjit, bontonit dhe traditës, kurse tjetra konfirmon se njeriu është pjesë e tërësisë në të cilën është fundosur dhe se specificiteti dhe kufijt e tij janë të pacaktuar, dhe se ai vetëm merr pjesë në aktivitetin e përgjithshëm, të cilit, ai dhe të tjerët i përkasin.

Pikëpamja e parë është qëndrimi i Islamit i cili nuk e mohon pavarësinë e personalitetit nga se i shërben tjetrit. Ai nuk e asimilon individin në tjetrin, pa marrë parasysh lidhjet e tyre farefisnore ose çfarëdo qoftë tjera të cilat për bazë e kanë simpatinë. Islami, krahas përpjekjes që t'i zhvillojë

raportet harmonike, dashurore dhe stabile ndërmjet burrit dhe gruas, ka kujdes, në të njëjtën kohë, në pavarshmëri dhe pavarësi të gruas në disponim me pasurin e vet. Ajo ka të drejtë të drejtojë me punët e veta apo së paku ta autorizojë tjetrin, pos burrit, në udhëheqje. Pasuria e gruas rëndon e tërheq shikimin e mashkullit, i cili shikon që në rastin e hyrjes në martesë, së paku, të ketë pjesëmarrje në të. Mirëpo, Islami, kur e largon burrin nga pasuria e gruas, jep shenjë për pavarshmërinë e saj dhe sinjal për ruajtjen e pavarësisë, pa marrë parasysh lidhjen e tyre martesore.

Nga ana tjetër, sado që Islami ngadalë llogaritet në propagandimin e besimit Islam, origjinalitetit dhe pastërtisë së shoqërisë Islame, posaçërisht familjes, ai i ndalon burrit të kërkojë nga gruaja e vet, e cila është jomuslimane, të kalojë në Islam. Kënaqet me atë që fryti i kësaj martese-fëmijët të bëhen muslimanë. Me këtë i jep të drejtë femrës që lirisht t'i shpreh ndjenjat e veta fetare.

Përveç kësaj që femra posedon pavarësinë pasurore dhe ideologjike, as personaliteti i saj nuk asimilohet ndaj burrit. Thjeshtë nuk ka arsye pse individit sipas Islamit do ta humb individualitetin e vet dhe të tretet në tjetrin. Subjektiviteti i personalitetit dhe personaliteti i saj janë një, kurse lidhjet e saj me personin tjetër në shoqëri janë prap tjetër gjë. S'andejmi çdo individ i janë garantuar edhe kufinj të paprekshëm, të cilët nuk guxojnë të përdhosen as të shkelen, pos me lejen e saj. Këto shenjtëri janë: shenjtëria e jetës, pasurisë dhe nderit.

Kur Islami i jep rëndësi të madhe pacenueshmërisë së banesës, nuk zë fill në botkuptimin se ajo është vetëm strehimore, vend i banimit, por se ka lidhje të fortë me specificitetin e personalitetit, e ky është nderi i saj. Banesa është perdja e këtij nderi, vendi ku familja lëviz pa frikë nga përzierja

e tjetrit dhe pikëpamjeve të tij. Për këtë Kur'ani thërret besimtarin që mos ta kalojë pragun e huaj shtëpiak pa lejen paraprake dhe pa ndjenjën e mirëseardhjes. Në këtë aspekt ai thotë:

“O besimdrejtë, mos hyni në shtëpi të huaja, derisa nuk u lejohet dhe derisa nuk i përshëndetni anëtarët e familjes!” (En-Nur, 27).

Me mirëseardhje këtu nënkuptohen dy gjëra: e para është leja për hyrje, kurse e dyta ndjeshmëria dhe kënaqësia e këndëshme me mysafirin. Nëse mysafiri edhe pas lejes për hyrje ndjen pakënaqësinë e shtëpiakut me ardhjen e vet, është më mirë të kthehet, sepse nuk është plotësuar kushti i dytë i mirëseardhjes. E detyra e atij që i bëhet mirëseardhje është t'i përshëndesë nikoqirët me përshëndetje Islame, me të cilën e përshëndet muslimani muslimanin, në shenjë të vërtetimit të sigurisë dhe qetësisë, nga arsyeja se marrëdhëniet reciproke të besimtarëve zënë fill, të paktën, në shmangien nga dëmi dhe ofendimi. Çështja se si e trajton këtu Kur'ani nuk është vetëm çështja e së drejtës së nikoqirit, sipas të cilit nuk guxohet t'i shkaktohet padrejtësi me hyrjen pa leje në banesë, por kjo më tepër është kujdesi mbi marrëdhëniet morale, fisnike dhe njerëzore të besimtarëve. Kjo në të vërtetë është kujdesi që sundimi të mbetet në duart e pavarësisë të vërtetë të tyre, çka paraqet gurthemelin e solidaritetit dhe kompaktësisë së shoqërisë Islame. Prandaj ajeti i theksuar, pas tërheqjes së vërejtjes në shenjërinë e banesës, është përshkruar me fjalët:

“Kjo është më mirë për ju, mësohuni.” (En-Nur, 27).

Pohohet se sjellja gjatë vizitës, si e përcakton ajeti i theksuar, është më mirë për marrëdhëniet reciproke të besimtarëve, me shpresë që kjo t'u bëhet orientim i përhershëm, sepse përmban dobinë e tyre të përbashkët. Nuk ka të mirë më të madhe se sa që marrëdhëniet e shoqërisë

Islame të jenë në bazë të vëllazërisë së pastër, respektimit të ndërsjell dhe garantimit të shenjtërisë së nderit, mbi të drejtën e të cilit askush nuk do të gabojë, e lere ta përdhosë atë.

Sikur Islami ta kundrojë individin nga aspekti i tërësisë dhe që ai të hyjë në konglomerat, duke e humbur specificitetin e ekzistencës së vet, sigurisht nuk do të kujdesej kaq shumë për individualizmin e persoalitetit dhe nuk do t'i përcaktonte të gjitha shenjtëritë të cilat janë në lidhje me të, e me të cilat tashmë jemi njoftuar. Vetëm kështu njeriu mund të ndjejë krenarinë dhe sigurinë e vlerës dhe nderit personal në familje, në shtëpi dhe në vendqëndrim.

FUQIA E BESIMTARIT

Besimtarët gabojnë në të kuptuarit e lidhjes së vet me All-llahun ﷻ nëse mendojnë se Islami është i izoluar nga jeta dhe rastet e fuqisë ose dobësisë dhe nga çastet e fitores ose humbjes që e përcjellin. Mashtrohen nëse llogarisin se mjafton nëse duan të jenë të fuqishëm, që vetëm ta pranojnë Islamin dhe të thërrasin në besimin Islam, qoftë fshehtas ose publikisht, individualisht ose grupisht, në xhamia ose jasht tyre. Besimi në All-llahun ﷻ, para së gjithash, ka të bëjë me aplikimin në jetë të parimeve të tij, të cilët duhet të jenë ligje të shoqërisë dhe themel të etikës. Ligjet e fesë rigorozisht janë të lidhura me rezultatet e caktuara, të cilat në asnjë rast, nuk mungojnë. Nëse hetojnë se ekziston disharmoni në jetën e shoqërisë apo individit ndërmjet parimeve, nga një anë, dhe rezultateve të pritura nga ana tjetër, menjëherë përfundojmë se parimi

përkatës nuk ka ndjekur rrugën e drejtë të aplikimit. Nga kjo del se gjendja e sotme e botës muslimane është pasojë e ndjekjes së konceptionit të cilin Islami e ka ndaluar.

Kështu, për shembull, Kur'ani e definojnë atë që besimtari duhet ta marrë për shok të sinqertë dhe në prehrin e të cilit duhet ta gjejë mbrojtjen. Garancia e kësaj miqësie është dinjiteti dhe fuqia e atij dhe shoqërisë që i përket, e nëse e lëshon dhe e goditë pafuqia dhe shkatërrimi le ta qortojë vetveten. Për këtë ai thotë:

“Mbrojtësit tu janë vetëm All-llahu dhe i Dërguari i Tij dhe besimtarët të cilët me përkushtim kryejnë namazin dhe ndajnë zekatin.” (El-Maide, 55).

All-llahu ﷻ pohon se rezultati i parimit të theksuar, nëse aplikohet me vend, është fuqia, lavdia dhe çdo e mirë tjetër:

“Ai që për mbrojtës e merrë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe besimtarët, - e- ana e All-llahut gjithsesi do të fitojë.” (El-Maide, 56).

Kur besimtari e merrë All-llahun ﷻ, të Dërguarin e Tij dhe besimdrejtët për miqë, ai vetëm aplikon në vepër konceptonet e Islamit, rezultatet e të cilit ndiqen gjatë kryerjes me përpjekje të dy ibadeteve themelore: namazit dhe zekatit. Kryerja e namazit sipas rregullit të caktuar e pastron shpirtin dhe e forcon dëshirën për shoqërim të tjerëve në jetën shembullore, duke ndihmuar edhe me solidaritet. Zekati mund të evitohet sëmundjet nga të cilat lëngon shoqëria, qoftë kjo me evitimin e urisë dhe varfërisë në pleqëri dhe në pamundësi të fitimit, duke ia kthyer të drejtën për ekzistencë të lirë njerëzore atij që për shkak të traditave të ndryshme që kanë dominuar në disa shoqëri është privuar nga ajo, duke i ofruar ndihmë atij që fatkeqësisht e ka humbur pasurinë apo

edhe me investime të cilat do t'i pengojnë mosmarrëveshjet ndër besimtarët dhe do t'i forcojë kundër armikut të përbashkët.

Besimtari që sinqerisht ndjek parimet e Islamit, pranon vetëm All-llahun ﷻ, të Dërguarin e Tij dhe besimdrejtët e përpiktë për miqë të vet. Në bazë të kësaj miqësie zhvillohet lidhje e fortë, për të cilën nuk ka shkëputje dhe e cila sundon dhe ngadhënjën. Në këtë kuptim është domethënia edhe e fjalëve të All-llahut:

“Le të jenë të sigurtë se do të ngadhnjejnë ata që mbahen fortë me All-llahun”(???)

Kur Kur'an'i e cakton, sipas asaj që konkludojmë nga ajeti i theksuar, kush është shok dhe miqësinë e cila duhet ruajtur, ai automatikisht i ndalon besimtarit ta shoqërojë atë që e nënçmon fenë dhe e konsideron për lojë, qoftë ai ithtar i konfesionit tjetër apo Mohues i ekzistencës së All-llahut ﷻ Kjo më së miri shihet nga ajeti Kur'anor që po e citojmë:

“O besimdrejtë, mos u shoqëroni me ata që përqeshen dhe tallen me fenë tuaj, as me ata që para jush u është dhënë libri, as me idhujtarët, -dhe frikësojuni All-llahut, nëse jeni besimtarë!” (El-Maide, 57).

Ai që nënçmon fenë është i barabartë me atë që luan me të. As njëri as tjetri nuk i respektojnë vlerat e larta morale, siç janë dinjiteti njerëzor, fisnikëria dhe humaniteti. Feja nuk është tregim për brezat e kaluar. Ajo më tepër është grumbull konceptimesh që thërrasin për etikë të lartë dhe flet për rezultatet e zbatimit apo moszbatimit të këtyre konceptimeve në jetë. Mik i mirëfilltë i besimtarit të vërtetë është vlera moralo-etike e përmendur në Kur'an dhe Hadith, në të vërtetë të prezentuara në personalitetin e besimtarit, është ai që këtyre vlerave nuk u jep kurrfarë rëndësie

apo i nënçmon ato. Shpëtimi dhe fitorja i përkasin atij që i pranon këto parime, kurse dobësia dhe shkatërrimi atij që ua kthen shpinën.

BESIMTARI NUK ËSHTË NË LAJTHITJE

Nuk ka sëmundje më të keqe e më të rrezikshme sesa kur njerëzit bien nën ndikim të epshit dhe i gjuhëzohen sprovës. Epshi vetvetiu nuk është sëmundje, duke e marrë parasysh se një pjesë e jetës është edhe themel i kënaqësive dhe bukurive të kësaj jete. Ai gjendet në çdo kohë dhe gjatë gjithë jetës së njeriut. Ndërkaq, nëse i nënshtrohem kërkesave dhe ndikimit të tij, shndërrohet në sëmundje e cila nganjëherë e arrinë atë shkallë saqë nuk mund të shërohet. Kjo është gjendja kur njeriu bëhet rob i epsheve dhe kur personaliteti i tij përjeton thyerje të plotë.

Pasuria, gruaja, fëmijët, nderi, pushteti... janë sprova të vërteta për njeriun, dhe si magjepsia me to rritet, ashtu dobësohet kompaktësia e shoqërisë dhe prishen lidhjet ekzistuese. Forca e personalitetit bie ashtu që vlerat morale dhe shoqëria në sytë e tij humbin cilësinë e vet. Në situatë të këtillë është shumë lehtë që njerëzit të orientohen kah ajo që ua dëshiron armiku, në vend të asaj që ia dëshirojnë vetvetes dhe asaj që nga ata kërkon bashkësi e tyre e ngushtë dhe e gjerë.

Është e pamundur plotësisht të izolohet natyra e personalitetit nga ndikimi i pasurisë, gruas, fëmijëve, nderit, pushtetit dhe të mirave tjera të kësaj bote, por është e mundur të pengohet, si te individi ashtu edhe te shoqëria nga shndërrimi në epsh me anë të vullnetit të lirë. Ky është

vullneti i cili doemos duhet ta gjejë vendin e vet të vërtetë në kujdesin të cilin ia ofron orientimi dhe edukata e drejtë. Në të vërtetë misioni i Islamit pothuaj edhe lëviz në rrethin e burimit të epshit dhe sprovës në jetën e njeriut, nga një anë, dhe kundërvënies epsheve që të mos bihet nën ndikimin e saj, nga ana tjetër. Ai qartë e përcakton prejardhjen e këtij epshi, pasojat e tij në psikën e njeriut dhe njëkohësisht tërheq vëmendjen në denimin dhe fundin katastrofal të individit dhe të shoqërisë. Po ashtu e precizon rrugën e vullnetit njerëzor deri te fuqia e plotë në mënyrë që të qëndrojë kundruall epshit dhe të gjitha provokimeve të tij.

Kur Kur'ani e bën burim të lajthitjes atë që e quan shejtan, ai pohon se rruga e vullnetit të fortë është besimi në All-llahun ﷻ dhe udhëzimi kah i cili thërret. Nëpërmjet dialogut me shejtanin janë paraqitur sprovat e kësaj bote, nga një anë, dhe kundërvënia atyre, për shkak të garantimit të ekzistimit të vlerave morale, nga ana tjetër.

“Dhe kur u thamë engjëjve: Përlujni Ademit!” - ata të gjithë, pos Iblisit, u përlulën. “A t'i përulëm atij që e ke krijuar nga argjili?”-tha: “Të shohim”-pastaj tha-”ja ky, të cilin e ke bërë më të mirë se unë: nëse më lejon deri në Ditën e shkatërrimit, sigurisht, përveç një numri të vogël prej tyre, pasardhësit e tyre do t'i mashtrojë.” “Shko”!-tha Ai. -”Atyre që do të të ndjekin ty, denimi i xhehennemit do të jetë denim i plotë. Dhe me zërin tënd mashtroje kënd të duash, dhe ndiqi ata me kalorësinë dhe këmbësorin tënde, dhe përzieju me ta në pasuri, dhe në fëmijë dhe premtouj atyre, -kurse shejtani vetëm gënjeshtria iu premtton. Por ti, vërtetë, nuk do të kesh kurrëfarë pushteti mbi robët e Mi!” , kurse Krijuesi yt është mbrojtës i mjaftueshëm!” (El-Isra, 61-65).

Ky dialog shtron shkallën e sprovave të kësaj bote: pasuria, gruaja, fëmijët, nderi, sundimi... dhe pasojat e tyre në rast se i tërheqin njerëzit në gjiun e vet, nëpërmjet provokimit të shejtanit All-

llahut ﷻ Po ashtu, tërheq vëmendjen në fuqinë e besimtarëve të vërtetë në kundërvënien provokimeve të tmerrshme të cilat sikur t'i kundërvihen vetëm natyra njerëzore pa besimin në All-llahun ﷻ, do të dominonin dhe do t'ia zhdukin kufijt e personalitetit. Që Kur'ani më butë t'i përcaktojë pasojat e lajthitjes dhe rezultatet e rënies në gjiun e saj, për individin dhe shoqërinë thotë:

“All-llahu është mbrojtës i të gjithë besimtarëve dhe Ai i nxjer nga terri në dritë, kurse atyre, që nuk besojnë, mbrojtës u janë shejtanët, e ata i shpiejnë nga drita në terr.” (El-Bekare, 257).

Ai që lirohet nga lajthitja dhe ndikimi i epshit, është sikur ai që ka dalur nga errësira në dritë. Mirëpo, kënd e mashtron shejtani, dhe i ndjek epshet në mirësjellje dhe në marrëdhënet me të tjerët, ai nuk e sheh qartë rrugën dhe është i ngjashëm me atë që shkon nga drita në errësi, sepse ka poseduar natyrën e pastër njerëzore dhe udhëzimin e All-llahut ﷻ, para se t'i përulet ndikimit, kurse kjo i ka mjaftuar ta ndjek rrugën nga e cila nuk ka kthim.

STABILITETI I BESIMTARIT

Një nga atributet më të rëndësishme që i shquan besimtarët, të dashurit e All-llahut ﷻ, është mosfrikësimi nga armiku, reciprokisht njëra palë nga tjetra, mosdëshprimi nëse iu shmanget diç që tjerët i gëzon apo kur i goditë fatkeqësia:

“Mos t’i frikësohen askujt dhe për asgjë mos të të mbrojturit e All-llahut: ata që besojnë dhe ata që i frikësohen All-llahut: (Junus, 62-63).

Besimtarët nuk i frikësohen armikut, për arsye se detyra e tyre është të jenë të gatshëm që t’i kundërvihen nëse ata i nxisin:

“Dhe kundër tyre përgatitu sa të mundeni fuqi dhe kuaj për betejë, që me këtë t’i frikësoni armiqët e All-llahut dhe tuajt, dhe të tjerët pos tyre-ju nuk i njihni, All-llahu i Dërguari. Çdo gjë që shpenzoni në rrugën e All-llahut, do t’u kompenzohet dhe nuk do t’u bëhet padrejtësi.” (El-Enfal, 60).

Kjo është gatishmëri për kundërvënien atakut të hapur, nga një anë, dhe atij të fshehur pas të cilit fshihet hipokrizia dhe mashtrimi, nga ana tjetër. Ajo nuk bartë vullë të armiqësisë as tiranisë:

“Nëse ata anojnë kah paqja, bëhu edhe ti, dhe mbështetu tek All-llahu.” (El-Enfal, 61).

Nëse besimtarët janë të gatshëm që t’i kundërvihen fuqisë materiale dhe morale të armikut, kurse kjo është karakteristike që duhet t’i shquajë, ai hamendet në provokim dhe në konfliktin e armatosur, ashtu që burimi i frikës dhe kërcënimit praktikisht nuk ekziston.

Besimtarët ndërmjet vete nuk frikësohen nga njëri tjetri, sepse burimi i frikës së brendshme qëndron në dominimin e ëndjeve, epsheve dhe ndjekjes së mashtrimeve të shejtanit, kurse ata sërish nuk mund të jenë besimtarë komplet, nëse All-llahu ﷻ nuk është mik i mirëfilltë në vend të shejtanit, siç tha ajeti i cituar Kur’anor. Sikur All-llahu ﷻ t’u jetë miku i vetëm besimtarëve dhe ata miq të Tij, d.m.th. që rrugën që e ndjekin në mirësjellje të jetë vërtetë Kur’anore, rruga e devotshmërisë dhe qëndrueshmërisë. Për të tillët Kur’ani thotë:

“Këta janë ata që besojnë dhe që i ruhen çdo të keqeje.”

Nga domethënia “të jesh mik i All-llahut” nuk kuptohet asgjë tjetër pos të jesh i devotshëm. Ajeti i cituar, kur pohon për besimtarët se janë miqë të All-llahut, njëkohësisht nënkupton që ata mos të frikësohen as mos të dëshprohen për asgjë. Një ajet tjetër e përmend po këtë, dhe ua atribuon edhe besimin konstruktiv në All-llahun ﷻ dhe qëndrueshmërinë në rrugën e drejtë:

“Atyre që flasin: Krijuesi ynë është All-llahu”, e pastaj mbeten në këtë, vijnë engjëjt: “Mos u frikësohuni dhe mos u dëshproni, dhe gëzojuni xhennetit i cili ju është premtuar.”^{xxxviii}

Devotshmëria identifikohet me besimin e sinqertë dhe me ndjekjen e rrugës Kur’anore:

“Elif, Lam, Mim. Ky libër në të cilin nuk ka kurrfarë dyshimi, është udhëzim për të devotshmit dhe ata të cilët besojnë në botën tjetër dhe falin namazin dhe një pjesë nga ajo që Ne ua kemi dhënë, e ndajnë, dhe atyre që besojnë në atë çka t’është shpallur ty dhe në atë çka është shpallur para teje, dhe atyre të cilët në ahiret thellë besojnë. Atyre Krijuesi i tyre rrugën e drejtë do t’ua tregojë dhe ata dëshirat e tyre do t’i sendërtojë.”^{xxxix}

Kur besimtarët individualisht i mposhtin ëndjet dhe epsheet e veta, atëherë as në shoqëri nuk gjendet kurrfarë burimi i frikës, i cili do të mund t’i brengoste, t’i përçajë ose t’i bëjë armiq ndërmjet vete, sepse urrejtja që i mbush zemrat, kjo gangrenë e njerëzimit, i ka rrënjët e veta në egoizëm dhe në vetmohim, kurse synimi i besimit është që ta zvogëlojë egoizmin dhe ta vendosë barazpeshën në mirësjellje dhe në luftën jetësore, duke lënë vend në të edhe për të tjerët dhe duke iu ndihmuar në mënyrë që angazhimi t’u bëhet i suksesshëm. Në këtë rast besimtari është në rrugën Kur’anore, është përdhur nga ana e Krijuesit dhe ka sukses në jetë:

“Këta janë ata që janë të shpëtuar dhe të cilët deri te synimi i tyre kanë arritur.”

Fakti se besimtarët nuk i frikësohen armikut, nuk do të thotë se ata janë plotësisht pa ndjenja dhe se u janë shterur forcat e brendshme të cilat janë burim i emocioneve të ndryshme. Ata janë njerëz, dhe sidoqoftë nuk dalin nga këto suaza. Qëllimi i citatit të përmendur është që fatkeqësitë jetësore mos t'i hamendin në besimin në All-llahun ﷻ në vlerat e larta morale dhe etikën njerëzore. Ndodhitë e përditshme kalojnë pranë tyre, e ata nuk i hetojnë as i ndjejnë. S'andejmi nuk dëshprohen nëse kurdoqoftë i goditë humbja e pasurisë, jetës dhe begatije, apo goditen me uri dhe skamje, apo edhe nuk u tregohet nderi dhe kënaqësitë e kësaj bote. Nuk vajtojnë gjërat që janë të karakterit sekondar, nga shkakut se qëllimi i gjallërimit nuk është vetëm të jetohej në këtë botë. Të tillët kanë, shpenzojnë materialisht, dhe dijnë për të drejtën që në pasurinë e tyre ka pjesë lypësi dhe i pafuqishmi. Kurse kur janë në pushtet, janë të drejtë dhe e mbrojnë të dobët. Nëse janë të dobët, punojnë për përparimin e së mirës, e jo të tiranisë dhe padrejtësisë. Fëmijët e tyre, nëse i kanë, nuk janë barrë për shoqërinë, por anëtarë të saj të dobishëm. Qëllimi i jetës së tyre është që ta takojnë Krijuesin e vet, që në fushën e moralit, drejtësisë dhe mirësisë ta arrijnë atë, që nga ata e kërkon besimi konstruktiv, edhe ndaj vetes edhe ndaj shoqërisë. Këto vlera sendërtohen në rend të parë me lëshimin jo të plotë në kënaqësinë dhe begatinë e kësaj bote dhe duke iu shmangur konflikteve në rrugën e sendërtimit të tyre:

“Ata që e duan jetën tokësore dhe bukurinë e tij, do t'i shpërblejmë sipas veprave të tyre. Në këtë fare nuk do të dëmtohen. Këta janë ata që në amshueshmëri i pret zjarri i tmerrshëm, kurse për veprat që i kanë bërë në tokë nuk do të kenë kurrfarë shpërblimi as çfarë dobie.” (Hud, 15-16).

BARABARËSIA DHE DHËNIA E PËRPARËSISË

1. Bota sot është arenë e konflikteve të shumta: konfliktit ndërmjet të bardhëve dhe zezakëve, konflikti ndërmjet popullit të këtij apo atij kontinenti, konflikti ndërmjet punëtorit manual dhe pasanikut, të paarsimuarit dhe të arsimuarit... Bota ishte çarë në fronte dhe taborre kundërshtarë. Realiteti i cilës do shoqëri e konfirmon këtë çarje të madhe siç flet edhe për konfliktin ndryshe të ngjyrosur ndër disa grupe, ndërsa varësisht nga fortësia e konfliktit dhe gjerësisë së përmasave të tij shtohen edhe drejtimit filozofike të cilët e arsyetojnë këtë apo atë qëndrim, apo thjesht e thellojnë konfliktin. Problemi i “barabarësisë dhe superioritetit” sipas vështrimit të këtyre drejtimeve, nuk është fenomen antropologjik, por çështje e kriterëve. Ngjyra e bardhë apo e zezë është kriter; pasuria apo skamja është kriter, analfabetizmi apo arsimimi janë kriterë.

Mirëpo, nuk ka dyshim në barabarësinë dhe dhënien e përparësisë si fenomen real antropologjik. Por kur natyra njerëzore, vetvetiu, është themel i barabarësisë, atëherë ku qëndron përparësia? A është në ngjyrë? Ngjyra nuk është tjetër pos pasojë e kushteve klimatike dhe gjeografike dhe për këtë ajo mund të ketë përparësi ndaj tjetrit, ose grupi ndaj grupit. A mos është atëherë në pasuri, mallë? Ajo i është nënshtuar shkatërrimit. Apo mbase është në skamje? Edhe kjo herëpashere shndërrohet në kundërshtinë e vet. Punëtori që sot orvatet, nesër bëhet pasanik. Sot ka një rol, kurse nesër një rol krejt tjetër... A mos është në analfabetizëm dhe në atë që e përcjell nëpërmjet mirësjelljes në jetën e përditshme? Edhe ai shpesh zhduket, e nuk është e rrallë që i paarsimuari të jetë më i moralshëm se i arsimuari. Këto kriterë nuk janë themel i përparësisë dhe nuk guxohet që kontesti, në lidhje me këtë problem, të shndërrohet në konflikt i cili e shkatërron edhe individin edhe shoqërinë. Më e saktë është ajo se këtu individit më së shumti humb. Këto kriterë nuk janë

themel i superioritetit të individit ndaj tjetrit, as grupet ndaj tjetrit nga shkaku i thjeshtë se ata nuk janë prodhim i natyrës së njerëzisë e cila është themel i barabarësisë dhe e cila paraqet shumën e specificitetit që dallon nga karakteristikat tjera të ekzistencës. Mendimi bashkëkohor që i arsyeton këto apo ato kritere është i karakterit lokal dhe nuk është fare në gjendje që vetes t'ia zgjedh formën e përgjithshme me anë të logjikës abstrakte. Po ashtu, nuk i shkon për dore ta mashtrrojë, sepse ky shekull shquhet me prosperitet të dukshëm në teknologji dhe aplikimin shkencor në të gjitha fushat e zhvillimit shoqëror.

2. Qëndrimi i Islamit (për shkak të lokalizmit, kufizimit dhe superficialitetit të filozofisë të konfliktit ekzistues njerëzor), është më ortodoks kur e konfirmon barabarësinë dhe superioritetin së bashku, duke u udhëhequr në këtë me natyrën njerëzore dhe me karakteristikat e saj të veçanta. Kur'ani thotë:

“O ju njerëz! Ne nga një mashkull dhe një femër ju kemi krijuar”. (El-Huxhurat, 13),

duke treguar atë se themeli i barabarësisë së të gjithëve qëndron në natyrën njerëzore. Pastaj vazhdon:

“Dhe ju kam bërë juve në popuj dhe fise, që të njoftoheni.” (El-Huxhurat, 13),

duke mohuar se ndarja në popuj, fise dhe grupe e arsyeton superioritetin e disave ndaj të tjerëve, në çka apelojnë disa doktrina bashkëkohore filozofike, s'andejmi kjo ndarje duhet të jetë shkak për njoftimin dhe takimet mes vete, e jo shkas për armiqësi dhe kthimin e shpinës tjetrit. Dallimet ndërmjet njërit dhe personit tjetër janë gjithsesi më të arsyeshme për takim dhe miqësi, siç është

këtu rasti me mashkullin dhe femrën, të fortin dhe të dobëtin, ose me të bardhin dhe të ziun. Kur’ani e vërteton edhe superioritetin, dhe shton:

“Më buajri ndër ju tek All-llahu është ai që është më i devotshëm. Vërtetë All-llahu di çdo gjë dhe është i informuar për çdo gjë.” (El-Huxhurat, 13).

Sipas ajetit tjetër Kur’anor, njerëzimi në tërësi është nderuar tek All-llahu ﷻ:

“Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit” (El-Isra, 70).

Mirëpo, në ajetin e përmendur paraprakisht theksohet bujaria ndër njerëzit, sikur që theksohet se kriteri i këtij superioriteti është devotshmëria (takvallëku). Por gjykimi për sasinë e devotshmërisë nuk i përket asnjë njeriu. Kjo është çështje e dijes dhe informimit të All-llahut ﷻ. Për këtë edhe ajeti i cituar përfundon me fjalët:

“Vërtetë All-llahu di çdo gjë dhe është i informuar për çdo gjë.”

Sa i përket natyrës së vet devotshmërisë, Kur’ani i precizon suazat e saj me fjalët:

“Nuk është mirësia në atë që ta ktheni fytyrën tuaj drejt lindjes dhe perëndimit, por mirësi është kush beson All-llahun, dhe në Ditën e Mbramë, edhe në engjëjt, edhe në librat edhe në felajmëruesit, dhe nga pasuria, edhe pse u është e dashur, u ndajnë të afërmeve dhe bonjakëve, dhe skamnorëve dhe udhëtarëve qëllim mirë dhe lypsëve, dhe për lirin nga robëria dhe ata që kryejnë namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kur e marrin një obligim, obligimin e plotësojnë, sidomos ata që janë tq qëndrueshëm në skamje dhe në sëmundje dhe në luftëra të rrepta, ata janë besimtarë të sinqertë dhe ata largohen nga veprimet e shëmtuara.” (El-Bekare, 177).

Kur'ani mohon se devotshmëria përbëhet në kthimin formal kah lindja apo përcaktimi me rastin e namazit. Devotshmëria është rrugë e besimit konstruktiv, ndihmesë vullnetare, falja e rregullt e namazit, dhënia e zekatit, përmbushja e kontratës, durimi në fatkeqësi, pastërtia e shpirtit dhe ndihmesa të nevojshmeve, këto në të vërtetë janë karakteristikat e humanitetit të vërtetë dhe pa të njeriu do t'i shoqërohej shtazës në egoizëm dhe ëndjet e saja.

Islami e barazon natyrën njerëzore por bën dallim ndër individët në bazë të pjekurisë së moralit të kësaj natyre. Garancia e ekzistimit të humanitetit dhe suksesit të shoqërisë qëndron në orientimin e personit drejt parimeve moralo-etike, e jo në drejtim të egoizmit dhe konfliktit për këtë shkak.

MALLËNGJIMI PËR PASTËRTINË E SHPIRTIT

Çdo individ si njeri komplet, është nën ndikimin e asaj çka mendon për tjetrin sikur edhe asaj çka vëren në jetën e tij. Kjo njëherësh është themeli për formimin e qëndrimit për të.

Nuk i bën dëm raporteve, ndërmjet vete nëse ajo që vërtetë te tjetri është objekt i krenarisë dhe lavdrimit në opinion. Mirëpo, bën dëm nëse është e kundërta, sepse ai që vëren në jetën e tjetrit diç që ndeshet me normat e morales, ai të paktën është i kujdesshëm në sjelljen me të nëse kursen nga ofendimi dhe shqetësimi. Dhe kështu raportet keqësohen. E ngjanjëherë atë çka njeriu e mendon për tjetrin nuk i përgjigjet realitetit, e herë herë kjo është mashtrim dhe dyshim i vërtetë. Qëndrimi dhe mendimi i tij janë të paqëndrueshëm, e ofendon dhe i bën keq, e që ky këtë fare nuk e meriton nga vëllai, me të cilin jeton në një bashkësi. Keqësimi i lidhjeve, në këtë rast, i

kthehet dyshimit të gabuar dhe për këtë Kur'ani, kur thërret për forcimin e lidhjeve mes besimtarëve, sepse aty këtu mund të ketë Dërguarin që momentalisht i rrënon, këshillon shmangien nga dyshimi, dhe thotë:

“O besimdrejtë, largojuni shumë dyshimeve! Disa dyshime vërtetë janë mëkat.” (El-Huxhurat, 12).

Nganjëherë, edhe përkundër asaj që në sjelljet e tjetrit, në jetën dhe në fushëveprimin e tij vëren keq, i mospërfill lidhjet me të ose e ofendon, gjenë edhe karakteristika të mira dhe kjo e bën të kënaqur dhe shpesh i pëlqen personaliteti i tij.

Kur'ani, po ashtu, ndalon depërtimin në fshehtësitë e të tjerëve dhe zbulimin e të metave të huaja, me numrimin dhe sistematizimin e tyre sikur jeta t'u ishte plotë të meta dhe nuk posedojnë asfarë cilësie as virtyti për t'u lëvduar. Kjo quhet spiunim të cilin e përmend edhe Kur'ani, pasi që e ka ndaluar dyshimin!

“Dhe mos e spiunoni njëri tjetrin.” (El-Huxhurat, 12).

Nëse në çdo individ ndikon ajo që e vëren në jetën e tjetrit, është e kuptueshme se do të jetë më i ndjeshëm ndaj atij që është në lidhje me personalitetin e tij, pa marrë parasysh shkallën e lartë të arritur në fushën e arsimimit, humanizmit dhe përvojës jetësore. Njeriu nuk dëshiron që të tjerët ta ofendojnë me atë çka nuk është i kënaqur dhe çka nuk don, qoftë ajo edhe e vërtetë, e sidomos nëse ajo është larg realitetit. Nëse ndodh që dikush t'i bëjë keq, kjo këtë e nxit në veprim johuman madje edhe ndaj atij që flet keq për të, kurse të folurit keq, shpesh dhe para së gjithash është përgojim. Nuk ka dyshim se sjelljet e këtilla dhe të ngjashme nuk kontribuojnë në ruajtjen e

marrëdhënieve të shëndosha reciproke; ata edhe në shumë po i pengojnë dhe rrënojnë. Për këtë ndalim të përgojimit, Kur'ani është i hapur dhe i qartë kur thërret në përbuzjen e kësaj cilësie jomorale:

“Dhe mos e përgojoni njëri tjetrin! Vallë, a dikujt prej jush do t'i pëlqejë ta hajë mishin e vëllaut të vet të vdekur, kurse kjo juve ju është neveritëse.” (El-Huxhurat, 12).

Këtë e krahason me ngrënien e mishit të vëllait që ka vdekur dhe trupi i të cilit është shkapërderdhur. Kjo është tejet neveritëse. Përgojimi paraqet padrejtësinë e dyfishtë ndaj të virgjërit, rruga dhe dyshimi në një anë, kurse përhapja e trillimit, në anën tjetër. Ajo është shenjë se njeriu në fjalë nuk ka turp, kujdes as humanitet në sjellje.

Për këtë Islami kërkon që shpirtërat të jenë të pastërt, të jenë larg nga dyshimi i gabuar, përcjellja e mungesave të të tjerëve dhe përgojimi i të virgjërve dhe të qetëve. Ai këtë e kërkon për shkak se cilësitë e këqia të cekura janë shenjë e logjikës së sëmurë dhe rrugës së keqe gjatë jetës. Është më e dobishme që besimtarët të bëhen ndërtues dhe të shtojnë çdo ditë risi në forcimin e raporteve reciproke, se sa t'i zhdukin. Logjika e sëmurë, jomorali dhe indiferenca kundruall jetës janë dëshmi të zhdukjes së pjesërishme, pasi që ishin vetëm shprehje e urrejtjes, e kësaj lëngate të fshehtë njerëzore. Është fatkeqësi që për njerëzit është më lehtë të urrejnë, se sa ta zbusin sëmundjen në shpirtëra.

ALL-LLAHU ﷻ DHE NJERIU NË ORIENTIM

Kur në fushën e orientimit të përmendet All-llahu ﷻ krahas me njeriun, mendohet në Kur'anin, besimin në të dhe pranimin e rrugës në të cilën thërret. Ndërkaq, kur përmendet njeriu kundruall All-llahut ﷻ në fushën e përmendur, mendohet në pavarësinë e njeriut në sjellje dhe veprime pa kthimin e parimeve të fesë dhe udhëzimit Kur'anor.

Nëse njeriu vepron në rrethin e tij të veçant, pa udhëzimin hyjnor bie në gabim. Ky gabim në fillim mund të jetë me pasoja të kufizuara, por kur pavarësia bëhet veçori e shumicës në shoqëri dhe kur të shumëzohen gabimet, të cilat janë prodhim i sjelljes së lië të privuar nga udhëzimi i All-llahut, Kur'ani, besimi konstruktiv dhe devotshmëria, njeriu shpesh nuk beson, as që mund të parashohë se çfarë dënimesh mund t'i godasin individin dhe shoqërinë. Ky dënim i njëjtë mund ta godet pavarësinë e personit përgjegjës për çështjen e përgjithshme. Nuk matet gabimi i sjelljes së lirë sipas asaj se a është ndonjëherë e pëmasave të kufizuara, e herë herë të gjera, por sipas asaj se në ç'masë personi largohet në veprime nga Kur'ani dhe mbështetet në vetvete dhe aftësitë e veta njerëzore. D.m.th., njeriut askush nuk i garanton se nuk do të gabojë nëse në orientin pavarësohet dhe mbështetet vetëm në vetëveten, sepse mendimi i grupit pa marrë parasysh numrin e tij, nuk ka vlerë për të mirën e përgjithshme, për shkak se nuk është i privuar nga faktorët që e ndjekin, qoftë kur këta faktorë hyjnë në strukturën e njeriut ose bëjnë presion mbi të me rastin e vendosjes dhe sjelljes. Njeriu në të vërtetë është bashkimi i emocioneve që grumbullohen, emocioneve të inspiruara nga ndodhitë e ndryshme dhe kushtet e veçanta jetësore. Për këtë edhe mendimi i njeriut është i kufizuar. Emocioni i gëzimit dhe vajtimit në mënyrë barabartë ndikon edhe në varietetin e veprimeve dhe rezonimeve të tij.

Që të evitohet ky kufizim në orientim dhe brenda mundësive të evitohet pasojat e gabimeve të tij, Kur'anit nuk lejon që i Dërguari i All-llahut ﷺ as muslimanët, gjatë kohës së jetës së tij dhe më vonë, ta marrin udhëzimin mbi vete, e ta mospërfillin Librin e All-llahut. Kjo kuptohet nga ajeti Kur'anor ku All-llahu ﷻ e qorton:

“Përse pos All-llahut të kërkoj gjyqtar tjetër, kur Ai ua shpalli librin e qartë?” (El-En'am, 114).

D.m.th. se nuk mund të ndjekin burim, udhëzim, dhe dispozita tjera pos Kur'anit në atë që është e lidhur për sjelljet dhe punët e besimtarëve përgjithësisht, përkohësisht moralin, dhe është domosdoshme që ta ndjekin vetëm atë. Nuk është kjo për atë se ai është objekti i udhëzimit të të gjitha llojeve, por që fjalët, konceptcionet dhe porositë e tij nuk vjetrohen dhe gjithnjë mbeten bashkëkohore, pa marrë parasysh kohën dhe brezat. Kur'anit do të mbetet i atillë deri në ditën e fundit. Këtë e pohon një nga ajetet e tij:

“Fjalët e Krijuesit tëndë janë apogje e së vërtetës dhe drejtësisë. Fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë dhe Ai çdo gjë dëgjon dhe çdo gjë din.” (El-En'am, 115).

Atë që e përmban Kur'anit paraqet të vërtetën, orientimin e rregullt dhe moralin e përpiktë. Ai është burim i drejtësisë për njeriun si individ dhe raportet e tij me të tjerët në shoqëri.

Pajtohet me natyrën njerëzore, nuk e smadhon, as nuk e nënçmon, kujdeset për specificitetin dhe karakteristikat e tij. Për shkak të këtij koekzistimi të tyre, natyrës njerëzore, i përket vlera, kurse Kur'anit amshueshmëria.

Që Kur'ani ta shtojë në shpjegim domosdoshmërinë e pranimit të Librit të All-llahut ﷻ si udhëzim në jetë, i qaset deskribimit të drejtimit i cili është i kundërt me atë Kur'anor, duke theksuar se kjo rrugë doemos e shpie shoqërinë nga jo e vërteta dhe jomorali:

“Nëse ti do t’u nënshtrohesh shumicës së atyre që jetojnë në tokë, ata nga rruga e All-llahut do të kthejnë, ata jepen vetëm pas supozimeve dhe ata vetëm gënjejnë. Krijuesit tënd i janë mirë të njohur ata, që kanë lajthitur nga rruga e Tij, dhe Ai mirë e Dërguari ata që janë në rrugë të drejtë.” (El-En’am, 116-117).

Kur'ani këtë e shpjegon në atë mënyrë, që njerëzit me anë të mendimeve të pavarura të ndjekin ambicjet personale, të cilat nuk paraqesin të vërtetën reale. Këto janë gjykimet dhe imagjinimet individuale, të cilat vetëm i mbajnë, dëshirat vetjake. Numri i tyre nuk i kontribuon vërtetësisë së tyre, shumësia e tyre është e natyrës sasiare, e jo cilësore. Kjo d.m.th. se mendimet e pavarura, pa marrë parasysh se janë të numërta, nuk dalin nga suaza e bindjes e cila është shenjë e epshit, dëshirës personale dhe ëndrrës.

Libri i All-llahut ﷻ kërkon që ky drejtim mos të pranohet si udhëzues në orientimin jetësor, sepse ata, ambicjet e të cilëve i mbajnë mendimet e tyre janë jo të sigurtë, spekulues: “... dhe vetëm mbahen në gënjeshtëri.” Kur'ani saktë e përcakton rrugën që ia trason njeriu vetvetes duke e mospërfillur Librin e All-llahut si udhëzim të përhershëm, dhe ekspozon parregullësinë e ndjekjes së saj:

“Vërtetë Krijuesi yt di kush ka lajthitur nga rruga e drejtë. Ai më së miri di ata që janë në rrugë të drejtë.” (El-En’am, 117).

All-llahu ﷻ e bën këtë nga shkaku se dëshiron ta bëjë me dije se vlerësimi për shumësinë e cila është larg nga udhëzimi i vërtetë i takon vetëm atij që është më së shumti i informuar mbi natyrën njerëzore, atij që sigurisht e din, kush është në rrugën e mirë, e kush është në lajthithje. Ky është All-llahu ﷻ, Një dhe i Gjithëmundshëm:

“Ai di çka ndodhur para tyre dhe çdo të ndodh pas tyre. Kurse nga ajo që i din të tjerët dijnë vetëm aq sa Ai don.” (El-Bekare, 255).

NDRYSHIMI SHOQËROR

All-llahu ﷻ nuk është i kënaqur me besimtarët për shkak të personalitetit të tyre, por me ta është i kënaqur pse besojnë dhe ndjekin parimet e Islamit. Edhe kur i ndihmon, i ndihmon nga shkaku i njëjtë:

“Ne vërtet do t’i ndihmojmë të Dërguarit Tanë dhe besimtarët në jetën e kësaj bote, e edhe në Ditën kur të ngrihen dëshmitarët, në ditën, kur shkatërruesve arsyetimet e tyre nuk do t’u ndihmojnë, ata i pret mallkim dhe vendbanim i keq.”^{xl}

Mirëpo, nëse ua abstenon ndihmën dhe ua shpreh pakënaqësinë e vet, kjo është për arsye se e kanë mospërfillur besimin. Është e domosdoshme që të tillët të ndërrohen me shoqërinë e cila e mbronë të vërtetën, lufton në rrugën e All-llahut dhe nuk i frikësohet qortimit as kërcënimit të njeriut.

Në tokë bashkë me të vërtetën me vullnetin e All-llahut gjendet edhe e pavërteta. kështu do të zgjasë deri në Ditën e gjykimit, prandaj duhet të ekzistojë grupi që e mbron të Vërtetën nga një anë, dhe tjetra që është kundër saj, nga ana tjetër:

“O besimdrejtë, nëse dikush nga ju bën renegatje nga feja e vet-dhe, All-llahu sigurisht në vend të tyre do të sjell njerëzit që Ai i don dhe ata e duan Atë, të mëshirshëm ndaj besimtarëve, kurse krenar ndaj jobesimtarëve, ata në rrugën e All-llahut do të luftojnë dhe qortimit të blasfemuesve nuk do t’u frikësohen.” (El-Maide, 54).

Por, cili është ai grup që meriton të hyjë në skenën jetësore në momentin e kërkuar?:

“Kjo është ndihma e All-llahut të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Dhuratat e All-llahut janë të bollshme dhe Ai di kush çfarë shpërblimi meriton.” (El-Maide, 54).

D.m.th. që gjithëpërfshirja e informimit të All-llahut e zgjedh ndër njerëzit grupin i cili është në gjendje të qëndrojë në mbrojtje të besimit konstruktiv në All-llahun ﷻ dhe flijohet në emër të tij. anëtarët e këtij grupi janë të vendosur dhe të fuqishëm në kundërvënien ithtarëve të së keqes dhe po aq modest dhe të butë në mirësjellje me vëllezërit nga feja.

Problemi i ndërrimit të një shoqërie me një tjetër është parim dhe ligj i jetës. Në të vërtetë, domosdoshmëria e ndërtimit identifikohet me domosdoshmërinë e ligjeve kozmike ku dominon harmonia e përkryer dhe ku kurrë nuk vjen deri te kaosi:

“Dhe nata u është dëshmi: Ne heqim dritën ditore dhe ata mbesin në terr. Dhe Dielli lëvizë deri te kufiri i caktuar, ky është urdhër i të Fuqishmit dhe Gjithdijshmit. Edhe Hënës ia kemi caktuar

kohën dhe ajo gjithnjë kthehet sikur thupra e vjetër e palmës. As Dielli s'mund ta arrijë Hënën, as nata ta kaloj ditën, të gjithë ata notojnë në gjithësi.” (Jasin, 37-40).

Ndryshimi për të cilin është fjala nuk imponohet nga anash. Ajo është rezultat i sjelljes së anëtarëve të shoqërisë dhe sipas llojit të veprimeve të tyre caktohet edhe shkalla e tyre, në ngadalësi ose shpejtësi, largësi ose afërsi, në rrugën për fund, kurse fundi i ndryshimit është fillimi i rimëkëmbjes. Në këtë kuptim është edhe ajeti Kur'anor:

“Kur të vendosim që një qytet ta zhdukim, do t'iu urdhëronim atyre, që janë mësuar në luks, që t'i jepen shfrenimit dhe që ashtu ta meritojnë denimin, dhe pastaj nga themeli do ta rrënonim ate.” (El-Isra, 16).

D.m.th. kur liderët dhe përfaqësuesit e pushtetit të një shoqërie të bëhen të pasur, kurse anëtarët tjerë të bëhen të kënaqur me lojërat dhe mëkatet e tyre, fundi është i domosdoshëm. Në gërmadhat e saj krijohet shoqëri e re, sjellja e së cilës është në kundërshtim me moralin e popullit që ka paraprirë. E vërteta del në dritë, vendoset drejtësia, mjetet materiale shpenzohen për qëllimet e caktuara saktë dhe çdo individë e di detyrën dhe rolin e vet. Edhe shoqëria e re i nënshtrohet ndryshimit dhe asgjë në këtë nuk dallon nga paraprakja ose e ardhmja, deri sa është në anën e së vërtetës dhe drejtësisë dhe All-llahu ﷻ e ndihmon, e posa i kthehet të keqes e pret fundi i cili as nuk vonohet as nuk mbetet prapa:

“Ata thonë: “Kur do të pasojë ai kërcënim, nëse është e vërtetë kjo që e flitni!” Thuaj: “Vetvetiu nuk mundem kurrfarë dëmi ta evitojë, e as ndonjë dobi vetes t'ia sjell, bëhet ashtu siç do All-llahu. Çdo popull ka fundin, dhe kur vjen fundi i tij, as për një çast nuk mund as ta shtyjë as ta shpejtojë.” (Junus, 48-49).

Për atë se çdo shoqëri, pa përjashtim, i nënshtrohet ligjeve të domosdoshme të ndryshimit Kur'ani thotë:

“Ne popujt e lashtë para tyre i kemi shkatërruar për shkak se nuk kanë besuar; të dërguarit e tyre dëshmi të qarta u kanë sjell, por ata nuk kanë dëshiruar të besojnë. Kështu e denojmë Ne popullin jobesimtarë. Pastaj, pas tyre, iu kemi bërë në Tokë mëkëmbës, që të shohim se si do të silleni ju.” (Junus, 13-14).

I Gjithdijshmi u drejton fjalim anëtarëve të shoqërisë së re, të cilët i ndërruan pararendësit, të cilët për shkak të dhunës, jomoralit dhe intrigave janë shkatërruar. Megjithatë, edhe përkundër dijes se çfarë do të jetë fundi i tyre, thotë: “Të shohim se si do të veproni”, të shpjegojë se ndryshimi që po ndodh në shoqëri, nuk është kurrfarë befasië, kthesë apo rastësi, por kompensim i llogaritur i anëtarëve të saj për sjellje, kurse për liderët orientim për udhëheqje:

“Kjo është për shkak që All-llahu nuk do ta privojë nga begatia popullin, të cilit ia ka dhuruar, deri sa ai vet nuk ndryshohet, kurse All-llahu çdo gjë e dëgjon dhe di...” (El-Enfal, 53).

All-llahu ﷻ kështu u ofron mundësi të mëdha dhe të shkëlqyeshme disa shoqërive duke pritur që në këtë begati t'i jenë mirënjohës, por ato lehtas e kuptojnë çështjen e fesë dhe rëndom në rastin e tyre dalin në shesh fjalët Kur'anore mbi ndryshimin:

“Atyre u kemi dhënë mundësi të cilat juve nuk ua kemi dhënë; edhe të dëgjuarit, edhe të pamit edhe zemrën u kemi dhënë, por as dëgjimi i tyre, as shikimi i tyre, as zemrat e tyre nuk kanë qenë të kurrfarë dobie, sepse shenjat e All-llahut i kanë mohuar-dhe nga të gjitha anët i ka rrethuat ajo së cilës i janë përqeshur.” (El-Ahkam, 26).

Ndryshimi është i domosdoshëm nëse shoqëria nuk e përfillë misionin e së vërtetës:

“Krijuesi yt nuk ka shkatërruar padrejtësisht fshatërat dhe qytetet, kur banorët e tyre kanë qenë të ndershëm.” (Hud, 117).

FORCA MATERIALE E SHOQËRISË NUK ËSHTË GARANCI E VETME E EKZISTIMIT TË SAJ

Sikur vetëm forca materiale e shoqërisë, e cila manifestohet në shëndet, pasuri, pasardhës, gatishmërinë për sulm ose mbrojtje, të shpiente kah solidariteti, pastërtia e shpirtit, paqja dhe dashuria, ajo vetvetes do t’i bëhej synim e jo mjet në rrugën e cakut tjetër.

Mjetet materiale shpiejnë drejt prosperitetit, urbanizmit dhe mirëqenies, e nganjëherë janë burim edhe i luksit, të të këqijave, shfrenimit e madje edhe rrënimit:

“All-llahut është krijues i qiejve dhe i tokës; Ai lëshon nga qielli ujën dhe bën me anë të tij bëhen frytet e me të cilat ushqeheni dhe u jep që t’i përdorni anijet, të cilat notojnë nëpër det, me vullnetin e Tij, dhe u jep t’i shfrytëzoni lumenjt, dhe u jep që ta shfrytëzoni Diellin dhe Hënën, të cilat gjithnjë lëvizin, dhe u jep që ta shfrytëzoni natën dhe ditën, dhe u jep nga gjithë ajo që nga Ai kërkoni, dhe nëse do t’i numëroni begatitë e All-llahut, nuk do të arrinit këtë.” (Ibrahim, 34).

Këto fenomene janë të natyrës materiale dhe pa dyshim janë bartës të fuqisë, urbanizmit dhe mirëqenies. Por çfarë do të jenë pasojat e tyre nëse njerëzit nuk ndjekin udhëzimin e All-llahut? Kur’ani mbaron ajetin e dytë nga këta dy të përmendurit me fjalët:

“Vërtetë njeriu është i padrejtë dhe jomirënjëhoës.” (Ibrahim, 34),

dhe ashtu përgjithësisht e shtron gjykimin për natyrën njerëzore, në rast që kjo natyrë lihet pa udhëzimin e All-llahut, apo njeriu e refuzon udhëzimin e All-llahut kur i paraqitet, duke bërë me dije se do t’i mohojë të mirat e All-llahut kur është në plotni. Natyra njerëzore me këtë refuzim vetvetes i bën padrejtësi, sepse bjen dhe dobësohet pasi ka qenë e fuqishme:

“A nuk po i sheh ata që, në vend të mirënjohjes All-llahut për begatitë, ia kthyen me mosmirënjohje dhe popullin e vet e kanë sjellë në shtëpinë e shkatërrimit.” (Ibrahim, 28).

Mosbesimi i tyre përbëhet në të shmangurit dhe në nënçmimin e udhëzimit të All-llahut.

Karakteristikë e materies është, po ashtu që ajo magjeps dhe mashtron:

“Do t’ju preokupojë garimi, deri sa varret nuk i shpërngulni (d.m.th. deri në vdekjen tuaj).” (Et-Tekathur, 1-2).

Kjo magjepsje me materien, pa vështrim në pasoja, ngren deri në lavdërim dhe mbështetjen vetëm në të:

“Në asnjë qytet Ne nuk kemi dërguar Pejgamber, e që nuk kanë thënë ata, që ishin mësuar në jetë luksoze: “Ne nuk besojmë në ata, që janë dërguar me anën tuaj!” dhe që nuk kanë thënë: “Kemi shumë pasuri dhe fëmijë, ne nuk do të mundohemi.” (Sebe’: 34-35).

Kjo është natyra e materies në magjepsjen dhe mashtrimin e saj dhe assesi nuk mund të numrohen sprovat e idhëta dhe të rrezikshme nëpër të cilat e shpiejnë njeriun në situatat e ndryshme jetësore. Fuqia e saj magjepsje, paraqet ligj shoqëror i cili është karakteristik për çdo shoqëri:

“Dhe sikur t’i mëshironim dhe nga fatëkeqësitë t’i çlironim, ata sërish në humbjen e tyre do të bredhnin njëjtë.” (El-Mu’minun, 76).

Për shkak të koordinimit preciz ndërmjet premisave dhe përfundimeve në ligjin shoqëror, Kur’ani në shumë vende ua tërheq vërejtjen përfaqësuesve dhe të gjithë anëtarëve të shoqërisë për pasojat e mbështetjes vetëm në fuqinë materiale dhe i fton në shfletimin e historisë, që të binden si janë bindur dhe zhdukur bashkësitë shoqërore, duke kërkuar prej tyre të ndalen në faktorët që doemos shpiejnë në ndryshim, në mënyrë që t’u shmangen në mirësjelljen e vet. Këta janë faktorët shoqërorë, e jo katastrofa natyrore. Këta janë faktorët që njerëzit mund t’i mposhtin, por edhe lehtë të gjuhëzohet nën ndikimin e valës së madhe materiale, kurse edhe më lehtë që të prezentohen në cilësi të tiranit, e kjo do të thotë fundi i ekzistimit të shoqërisë:

“Përse ata nuk udhëtojnë nëpër botë, që të shohin se si kanë përfunduar ata para tyre? Ata kanë qenë më të fortë se ata, dhe tokën e kanë lavruar dhe e kanë punuar më shumë se që kanë punuar këta.” (Err-Rrum, 9).

Kur’ani këtu konkretisht jep shenjë në dy vende, Bizantin dhe Persinë, në shekullin e gjashtë të erës sonë. Ato kanë poseduar aq mjete materiale, forcë dhe fuqi sa që historia i ka radhitur në rradhën e dy mbretërive më të mëdha të asaj kohe, por fundi i kësaj fuqie dhe madhësie që përcjellur me konfliktin e tyre reciprok. Përfundimisht u shkatërruan për shkak të gabimeve,

çarjeve dhe dhunës së tyre. Shkaku i vetëm për këtë ka qenë mbështetja e dyanshme vetëm në faktorin material, duke e asgjësuar mendimin dhe udhëzimin e All-llahut:

“Dhe All-llahu nuk u ka bërë dhunë, por ata vtevets. Pastaj fundi i atyre që bëjnë keq ndodh dhe mbaron me të keq, sepse ata i mohojnë dhe i konsiderojnë të rrejshme shenjat e vërteta të All-llahut dhe atyre u përqeshen.” (Err-Rrum, 9-10).

Shoqëria që ka merituar të krijohet në gërmadhat e dy perandorive të përmendura ka qenë shoqëri e besimtarëve në All-llahun ﷻ në siujdhesën Arabe, e ndihmuar me ndihmën, madhështinë dhe mendimi është i All-llahut

dhe atëherë besimtarët do t'i gëzohen ndihmës së All-llahut. Ai i ndihmon kujt të dojë, Ai është i fuqishëm dhe mëshirplotë.” (Err-Rrum, 4-5).

Kjo ndihmë ka ardhur në shprehje të plotë kah fundi i çerekut të parë të shekullit të shtatë të erës së re, pas persianëve dhe Bizantëve në vitin 622, dhe pas fitores së besimtarëve kundër jobesimtarëve-Kurejshitëve. Në të njëjtën kohë bie edhe fitorja ndaj aleatëve persianë në Bedër më 624:

“Është premtimi i All-llahut, dhe All-llahu do ta potësojë premtimin e Vet, por shumica e njerëzve këtë nuk e di.” (Er-Rrum, 6).

All-llahu ﷻ ka premtuar se do t'i ndihmojë besimtarët dhe do t'u jep mundësi më të mëdha se sa atyre që janë në anën e të keqes, shfrenimit dhe të cilëve materia, e cila u mundëson që të prezentohen si tiranë, u është bërë idhull:

“Kurse All-llahu sigurisht do t’i ndihmojë ata, që fenë e Tij e ndihmojnë.” (El-Haxh, 40).

NDIHMA E ALL-LLAHUT

Ndihma e All-llahut është rregull i amshueshëm për atë që e ndihmon thirrjen e All-llahut. Përfundim i këtij rregulli nuk mbetet pas premisë, e kur njeriu e ndihmon All-llahun ﷻ edhe vetë atij i është garantuar ndihma:

“E All-llahu sigurisht do t’i ndihmojë ata, që besimin e Tij e dihojnë. All-llahu vërtetë është i fuqishëm dhe i furishëm.” (El-Haxh, 40).

Njeriu e ndihmon All-llahun ﷻ ashtu që beson korrektësisht dhe jeton në pajtim me konceptonet me të cilat ka ardhur Islami, kurse të cilat janë përmbajtur në Kur’an dhe në Hadith të Dërguarit të All-llahut.

Karakteristikat e misionit të Islamit është edhe kjo që kërkon nga besimtari që kur të dojë, të dojë vetëm në emër të All-llahut ﷻ dhe i Dërguari i Tij, të jenë më të dashur nga jeta e tyre vetjake, pasuria, pasardhësit, farefisi... në të vërtetë nga kjo botë dhe çdo gjë që është në të. Kjo vjen në shprehje nëpërmjet veprimeve të tij bujare dhe humane ndaj kërkesave të ajeteve Kur’anore:

“Atë që duan, besimtarët do ta arrijnë, ata që në lutjet e tyre janë të përlur, dhe të cilët, atë çka s’u intereson i shmangen, dhe të cilët sadakë ndajnë, dhe të cilët vendet e turpshme të tyre i fshehin, -pos prej grave të tyre ose atyre që janë në posedim të tyre, të tillët, vërtetë, nuk

meritojnë qortim, kurse ata, që edhe përveç kësaj kërkojnë, ata më të keqen e tepeojnë,-dhe të cilët për gjërat e besuara dhe obligimet e veta kujdesen, dhe të cilët namazet e tyre i kryejnë me rregull.” (El-Mu’minun, 1-8).

Këto ajete numrojnë tri lloje cilësish që e karakterizojnë sjelljen pozitive të besimtarit dhe ato konsiderohen si garanci e ndihmës së All-llahut atij. Në llojin e parë bën pjesë kryerja e rregullt dhe me rregull e namazit dhe dhënia e zekatit. Në llojin e dytë është specifik ndalimi i përdhosjes së nderit nga ana e trajtave më të ulëta të saj, përgojimit të parëndësishëm e deri te trajtat më të larta, prostitucioni. Lloji i tretë është ngusht i lidhur me raportet konstruktive reciproke nga përmbajtja e kontratës deri te të gjitha obligimet shoqërore. Atij që i atribuohen këto cilësi nuk e shqetëson, nuk e ngarkon shoqërinë, e as që tek ai gjendet diç e keqe, apo vepër e keqe; përkundrazi, ruan shoqërinë nga çarjet dhe zgjerimi i urrejtjes, kontribuon që solidariteti i anëtarëve të tij gjithnjë të mbetet i fuqishëm dhe i pastër. Është besnik dhe posedon ndjenjë të fuqishme të përgjegjësisë dhe dëshirë të sinqertë t’i plotësojë obligimet ndaj vetvetes dhe besimtarëve në bashkësinë e vet. Është kozmopolit dhe kjo manifestohet nëpërmjet ruajtjes së tij nderit të huaj. Frikësohet që mos t’i afrohet as nga afërsia as nga largësia. Pastërtinë e shpirtit e ka arritur nëpërmjet pranisë përulëse me All-llahun ﷻ me anë të lutjes dhe mirësisë. Rregullisht kujdeset për namazet dhe shitblerja nuk e pengon në rrugën e tij. Ky besimtar vërtetë e ka ngadhënjyer armikun e njeriut, epshin. E ka ngadhënjyer shfrenimin dhe çdo prirje kah e keqja. Fuqinë të cilën tek ai e paraqet amorali është mposhtur pos asaj me çka janë të kënaqur All-llahu ﷻ, etika e lartë dhe shoqëria së cilës i përket. Sikur shoqëria të përbëhej nga besimtarët e këtillë, fitimtarë do të kishte në të dy frontet, të brendshëm dhe të jashtëm. Do të fitonte në vete

kundërshtarin e çuditsëm, të shpirtit, epshit, dhe njëkohësisht do ta fitonte armikun e jashtëm në rrugën e drejt të misionit, ideologjisë dhe sjelljes.

Ai që e ngadhënjen veten automatikisht i ka ngadhënjyer edhe armiqtë e vet. Armiqtë e tij nxitojnë për nder dhe pas të gjitha atyre që e përcjell duke mos zgjedhur mjete gjatë kësaj, shërbehen me hipokrizi, me kërkimin e hapur ose me armiqtësi... por ky megjithatë fiton, sepse është më i durueshëm prej tyre në vështirësitë jetësore, është më pak i interesuar për jetë, deri sa ato janë më tepër të kthyer kah begatitë e tij. Lufta e tyre është jetëshkurtër. E lënë, nëse shohin se mund ta shpëtoj kryet nga vdekja, e cila, natyrisht, supozohet nëse kjo luftë vazhdon për sendërtimin e cilitdo qëllim.

Të vërtetën e thotë All-llahu ﷻ kur thotë:

“Vërtetë All-llahu do t’i ndihmojë ata që e ndihmojnë Atë. Ai është i gjithmundshëm dhe i fuqishëm.” (El-Haxh, 40).

Me konkludimin “Ai është i gjithmundshëm dhe i fuqishëm”, All-llahu ﷻ i dëshiron besimtarit fuqinë dhe madhërinë, rruga e të cilit është ajo që tashmë e kemi përmendur. Asesi nuk i dëshiron dobësi as molisje, rruga e të cilit është mashtrimi i shejtanit, sundimi i epshit dhe tirania e materies në mendim dhe në sjellje.

E VËRTETA NUK VDES

E vërteta dhe drejtësia nuk munden në asnjë rast të zhduken nga kjo botë si sakrificë të dhunës, pa marrë parasysh sa do të jetë i madh numri i prepotentëve dhe tiranëve. Patjetër duhet të ekzistojë grupi, qoftë mes territ, i cili është në rrugën e së vërtetës dhe i cili praktikisht i aplikon konceptionet e drejtësisë, së paku mes vete. Nëse nuk ka grup të atillë, atëherë ka individë të cilët me mundësitë e veta punojnë në realizimin e këtyre parimeve:

“E në mesin e atyre, që i krijojmë, ka njerëz, të cilët të tjerët i udhëzojnë kah e vërteta dhe të cilët sipas saj gjykojnë drejtësisht.” (El-A’raf, 181).

Shprehjet “udhëzon në të mirë” dhe “ata drejtësinë dhe të vërtetën e zgjerojnë” Kur’ani i përdorë në trajtën e kohës së tashme që të theksojë se ky grup është i amshueshëm dhe se ky është grumbull besimtarësh që gjendet në çdo kohë. Rruga e këtij grupi është e vërteta, kurse e vërteta është udhëzim prej All-llahut ﷻ. Kështu ky grup e aplikon drejtësinë në bazë të udhëzimit të All-llahut, i cili gjithnjë gjendet me njerëzimin pa marrë parasysh se do të jetë errësuar atmosfera. Ekzistimi i udhëzimit nuk është i kushtëzuar vetëm me konfliktin ndërmjet së vërtetës dhe të pavërtetës, as me caktimin e All-llahut me krijimin e burimeve të tyre, por e pavërteta vetvetiu kërkon ekzistimin e së vërtetës. Kjo është në të vërtetë ashtu si terri i natës që e lajmëron agimin. Shfaqja e së vërtetës në këtë rast i përgjigjet lindjes së diellit. Ekzistimit të së vërtetës nuk i pengon nëse për një periudhë të caktuar nuk i dëgjohet zëri, sikur që edhe terri i natës nuk do të thotë se drita nuk ekziston para agimit dhe lindjes së Diellit.

Kjo është natyra e gjërave dhe jetesës. E vërteta dhe pavërteta, drejtësia dhe padrejtësia, janë pjesë përbërëse e kësaj natyre në të cilën bën pjesë fuqia dhe dobësia, fuqia në një periudhë, kurse dobësia në tjetrën, pas së cilës vjen periudha e re e fuqisë dhe sërish dobësisë dhe kështu me radhë. E sa i përket zhdukjes së tërësishme të së vërtetës dhe drejtësisë, sikur edhe zhdukjes së vërtetës të së vërtetës dhe të pavërtetës, kjo nuk do të ndodh deri atëherë sa nuk pushon ekzistimi njerëzor në tërësi dhe jeta në këtë botë. Vdekja dhe zhdukja, të cilën ne e vërejmë është karakteristikë e individit, e kjo edhe e vet llojeve. Në stilin e komparacionit mund të thuhet se dobësia e së vërtetës ose të pavërtetës, në një periudhë, i përgjigjet vdekjes së individit, kurse fuqia e cilësdo prej tyre në periudhën tjetër, është e ngjashme me lindjen e re.

Njeriu i cili një periudhë të caktuar është në anën e së pavërtetës dhe padrejtësisë, nuk ndërron në qenien e tij. Ai, atëherë vetëm e mospërfill funksionin e vërtetë, begatitë me të cilat All-llahu ﷻ e ka dhuruar. Këto begati janë zemra dhe arsyeja; mbyll zemrën para besimit në All-llahun ﷻ dhe i drejton mendimet vetëm në kënaqësitë e kësaj bote dhe ato që i përcjell nga dekoket dhe lavditë. Kujdeset vetëm për vetveten dhe i kënaq ëndjet e veta. Më shumë jeton për sot se për nesër, sepse ai që jeton për nesër i supozon edhe vetë rreziqet e kësaj të cilat bëhen barrierë e caktuar për bashkim të tjerëve në dëfrime dhe ëmbëlsirë:

“Ne për xhehennem kemi krijuar shumë xhinnë dhe njerëz; ata kanë zemër por me to gjë nuk kuptojnë, ata kanë sy - por me ta nuk shohin; ata kanë vesh-por me to nuk dëgjojnë.” (El-A’raf, 179).

Ky është shembull i atyre që e zgjedhin të keqen dhe i ndjekin rrugët e tiranëve nëpërmjet obligimeve ndaj vetes dhe të tjerëve. Mënyra se si i përdorin ata të mirat e All-llahut është

krejtësisht negative dhe gjatë kësaj jo vetëm që i humbin cilësitë njerëzore dhe lëshohen në shkallën më të ulët njerëzore, por bien krejt poshtë, në shkallë të shtazëve. Shtaza me animalitetin e vet, me egërsinë, egoizmin dhe luftën për ekzistencë nuk del nga suazat e natyrës së vet. Ajo vetëm e demonstroi natyrën, në të cilën është krijuar. Prandaj njeriu, si i zgjedhur, kur e mospërfill specifikitetin e zemrës dhe arsyes dhe ndjek drejtimin e shtazës, duke i shkatërruar në vete karakteristikat njerëzore, nuk është i barabartë as me shtazën, sepse nuk e posedon fuqinë e saj të lakmisë dhe makutërisë. Për këtë është më i ulët se ajo:

“Ata janë sikur shtazët, madje edhe, më t këqij - asgjë s’u intereson.” (El-A’raf, 179).

Janë më të këqinj se shtazët, sepse nuk e kanë ashtu të zhvilluar fuqinë e pasioneve sikur ato, nga një anë, ndërsa i kanë mospërfillë karakteristikat njerëzore me të cilat janë krijuar, nga ana tjetër. Kanë lajthitur dhe gjenden në kllapi. Nuk janë ende të gatshëm që ta kuptojnë mirësinë dhe detyrën e jetës.

Pasi që e vërteta dhe drejtësia kurrë nuk e braktisin krejt këtë botë, kjo është edhe shpresa që sërish të dominojnë dhe forcohen, përgjithmonë. Pakicës së besimtarëve që është në rrugën e vërtetë, e kjo është pakica e përherëshme në shoqërinë në të cilën dominojnë padrejtësia në sjellje dhe e pavërteta në mendim dhe orientim, nuk i mbetet gjë tjetër pos të këmbëngulin, sepse këmbëngulësia në rrugën e së vërtetës dhe drejtësisë do t’i nxisë dhe forcojë edhe të tjerët që t’i ndjekin. Kështu do të rritet numri i ithtarëve të së vërtetës në llogari të ithtarëve të së pavërtetës dhe drejtësisë do ta ngushtojë fushën e padrejtësisë.

Ekzistenca e së vërtetës është e lidhur me të ekzistuarit a atyre të cilët në të besojnë, kurse dominimi i saj me rritjen e numrit të ndihmëtarëve të saj. Shpresa është sërish rruga e pushtetit

dhe fuqisë së saj. Deri sa njeriu e kupton se nuk ka zhdukje të udhëzimit të Allahut, pa marrë parasysh se zëri nganjëherë po i dëgjohet në dobi, ai supozon që drita e saj do të shëndrisë në kohën më të afërtë qoftë edhe të mos u pëlqejë kjo jobesimtarëve. Kur besimtari shpreson në këtë, nuk jeton në iluzione por në realitet, në të cilin zë fill ekzistenca complete ashtu si e ka krijuar All-llahu ﷻ dhe si e rregullon me ligjet permanente, për të cilat s'ka ndryshim:

“E sikur të kishte dëshiruar Krijuesi yt, të gjithë njerëzit ithtarë të një feje do t'i bënte. Mirëpo, ata gjithnjë në besim do të ndahen, pos atyre që Krijuesi yt u mëshirohet, e për këtë edhe i ka krijuar.” (Hud, 118-119).

Konflikti më në fund megjithatë do të mbarojë me humbje të pavërtetës dhe ithtarëve të saj:

“Ne në Zebur, pas Tevratit, kemi shkruar, se Tokën robët e Mi të ndershëm do ta trashëgojnë.” (El-Enbija, 105).

ISLAMI NUK ËSHTË SPIRITUALIZËM I PASTËR AS MATERIALIZËM EKSTREM

Islami i kundërvihet materializmit, i cili jo vetëm që mohon çdo gjë jomateriale, por nxit në delikt, gënjeshtër dhe veprë të keqe, qoftë ajo publike ose e fshehtë. Islami është edhe kundër spiritualizmit të pastër, i cili rekomandon izolimin nga kjo botë dhe nga kënaqësitë, stollitë dhe

bukuritë e saj. Kjo d.m.th. që ndalon teprimin në begati, sikur që ndalon edhe abstenimin nga ato. Islami i ndalon që të dy këto drejtime, sepse i pari, materializmi, i bën dëm shoqërisë, kurse i dyti, spiritualizmi, është i drejtuar kundër individit. Prandaj e rekomandon midisin, maturinë ndërmjet teprimit dhe abstenimit. Kur'ani thotë:

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur, kur doni ta kryeni namazin! Edhe hani, edhe pini, por mos e tepron! Ainuk i don ata që e teprojnë.” (El-A'raf, 31).

Kërkon veshje të bukur me rastin e çdo shkuarje në xhami, ashtu edhe gjatë çdo takimi, qoftë ai ndërmjet burrit dhe gruas ose farefisit. Kërkon që të hanin dhe pinin ushqime dhe pije të mira dhe të lejuara.

Është i lejueshëm dëfrimi në begatitë dhe stolitë e kësaj bote. Në fakt, Kur'ani edhe këtu ndalon teprimin dhe thyerjen e normave të të maturës. Që Kur'ani vërtetë të pohojë këtë lejueshmëri, i kundërvihet atij që këto kënaqësi ia ndalon vetvetes:

“Thuaj: Kush i ka ndaluar stolitë, të cilat i ka krijuar All-llahu për robët e vet, dhe ushqimet e shijshme!” Thuaj: “Ato janë për besimtarët në këtë botë, në atë botë janë vetëm për ata. “Ja kështu Ne hollësisht i ekspozojmë ajetet njerëzve që dijnë.” (El-A'raf, 32).

Kur në këtë mënyrë e mohon ndalimin e kënaqësisë në begati, njëkohësisht dhe haptas deklaronte se ata i përkasin besimtarëve dhe të tjerëve që jetojnë me ta në këtë botë, duke theksuar se ata di t'i shfrytëzojnë vetëm besimtarët në botën e ardhme. D.m.th. që kjo shkon në llogari të lejimit të tyre. Nuk ekziston sot as dyshimi më i vogël se shfrytëzimi i begative botërore nuk është i lejuar. Numërsia e tyre është lejuar dhe kjo në kufij të mesit të artë. Mirëpo, kur me këtë teprohet,

ndalimi i Islamit është kategorik, sepse përdorimi i tepruar në bukuritë dhe begatitë e kësa bote shpie drejt shumë mëkateve, siç janë:

-kundërvajtjet shoqërore,

-shfrenimi në sjellje dhe padrejtësia ndaj të tjerëve,

-përshkrimi shok All-llahut ﷻ,

-të folurit e panevojshtëm dhe gënjeshtër për All-llahun ﷻ.

Ai që është i pangopur për dëfrime nuk ndalet në kufirin e lejuar dhe të caktuar. Në rast se nuk ka mjete materiale, pangopësia e shtyn në vjedhje dhe prostitucion dhe e shpie në veprim të padrejtë me anëtarët e familjes vetjake, sikur edhe me ata për të cilët është i detyrueshëm të kujdeset, nëse të drejtat e tyre i sjellin në pyetje dëfrimet e tyre. I tilli i verifikon çdo gjë që i vie në dorë, kurse duke ia afruar litarin e shpëtimit burimeve të ëndjeve të veta synon që vetëm të mbetet në shoqërinë e kënaqësive. I kthehet asaj ashtu si ai që i drejtohet idhullit të vet, duke e lutur për plotësimin e dëshirave. Materia është qëllimi i tij dhe nuk sheh asgjë tjetër pos saj. Vlerat jomateriale sikur as devotshmëria nuk meritojnë angazhimin për respektimin sipas botëkuptimit të tij. Për këtë është lehtë që në rrugën e sendërtimit të kërkesave të materies të blasfemojë dhe gënjejë All-llahun ﷻ i cili ia tërheq vërejtjen për Vetën dhe për rrugën e drejtë. Kur’ani, kur i komenton këto pyetje thotë:

“Thuaj: “Krijuesi im ndalon shfrenimin, edhe publik edhe të fshehur, edhe mëkatet, edhe dhunën e paarsyeshme dhe që All-llahut t’ia konsideroni të barabartë ata për të cilët Ai kurrfarë dëshmie nuk ka shpallur, dhe që për All-llahun të flitni atë që nuk dini.” (El-A’raf, 33).

Komenti Kur'anor i ndalimit të kundërvajtjeve të theksuara është në stilin e rezultateve dhe pasojave të përdorimit të tepruar në begatitë e kësaj bote. E ndalon teprimin, sepse ai është shkak i këtyre mëkateve. Kurse ndalimi i shkaqeve, nëse kihet parasysh, ajo që do të shkaktohet gjithsesi është më i fuqishëm, sepse në vete fshehin pasojat e domosdoshme të cilat e dëmtojnë delikuentin dhe bashkëqytetarët e tij.

Të rezymojmë: Islami është feja e jetës reale, feja e natyrës njerëzore e cila mund të jetojë pa dorëzim të plotë, epsheve të stomakut dhe instiktit seksual, sikur edhe pa fyerjen e dinjitetit njerëzor të tjetrit gjatë aktivitetit të tij. Kjo natyrë mund të jetojë me jetë fisnike të njeriut që posedon arsye të shëndoshë dhe zemër të sinqertë.

SPROVAT NË KËTË BOTË

Kjo botë është prezentuar nëpërmjet gruas, fëmijëve dhe pasurisë të të gjitha trajtave: arit, argjendit, botës bimore dhe shtazore. Mirëpo, këto begati bëhen mashtrim dhe sprovë nëse rriten në epsh. Por para se të bëhen këto ekziston periudha e shfrytëzimit dhe përdorimit të tyre korrekt.

Kjo botë dhe çdo gjë që është në të e ka krijuar All-llahu ﷻ Ai i ka krijuar edhe burimet e sprovave edhe pasionet, sikur që i ka krijuar burimet e kënaqësive dhe të dobisë. Por kjo nuk është e keqe skajore, as që është ndaluar që njeriu t'i shfrytëzojë këto begati në jetë, në raporte me të tjerët. Sikur Islami si fe prej All-llahut ﷻ t'i ndalojë kënaqësitë dhe stolitë e kësaj bote, prej kur

ka filluar misioni i tij e deri te Muhammedi ﷺ do të ishte larg nga natyra njerëzore dhe karakteristikat e tij, ai tash do të kërkonte nga njeriu të pamundshmen, nëse kemi parasysh funksionet fiziologjike të organeve të tij. Për këtë Kur’ani këtë botë e vë para njeriut dhe ia tërheq vërejtjen se kjo njëkohësisht i është sprovë dhe mashtrim, nëse vetëm atij i përkushtohet:

“Njerëzve iu duket se e mirë është ajo çka lakmojnë: femrat, fëmijët, grumbulli i arit dhe argjendit, kuajt e shkëlqyeshëm, kafshët dhe të lashtat. Këto janë begatitë në jetë në këtë botë (e tek All-llahu është strehimorja me e bukur).” (Ali-Imran, 14).

Shprehja Kur’anore “kënaqësitë” për gratë dhe fëmijët tregon se ata janë sprovë dhe mashtrim, sepse posedojnë karakteristikën e mashtrimit, sidomos nëse njeriu lehtë bie në ndikimin e tyre dhe u ofrohet për këtë rasti dhe mundësia.

Femra nuk është sprovë sipas asaj se njeriu ndjen simpati ndaj saj. Në të vërtetë simpatia ndaj femrës dhe lidhja e ligjshme me të është çështje natyrore. Mirëpo, ajo bëhet sprovë dhe mashtrim nëse kjo lidhje normale shndërrohet në pasion dhe bëhet qëllimi i vetëm në jetë.

Shprehjet “grumbull” për argjendin dhe arin dhe “të shkëlqyeshëm për kuajt, tregojnë në sprovën për pasuri. Këto pasuri nuk paraqesin sprovë nëse fitohen dhe shërbejnë për plotësimin e nevojave. Ato nuk janë këto as në sasi të mëdha, kur shpenzohet në aspekte të ndryshme si ndihmë të tjerëve. Pasuria është sprovë dhe mashtrim kur grumbullimi i saj bëhet pasion i tubimit të përhershëm, dhe kujdesi i përhershëm mbi lëndët e para nga të cilat fitohet, ashtu si toka dhe bota shtazore.

Kur Islami thekson se kjo botë paraqet sprovë për mashkullin me gruan, pasardhësit dhe pasurinë, dëshiron t'ia tërheq vërejtjen njeriut në rrezikshmërinë e shndërrimit të të mirave të kësaj bote në të keqe të tij. Sprova me gruan, përkatësisht simpatia e tepruar ndaj gjinisë femrore, kthehet me shumë të këqia, ashtu që ai që lëshohet në të, rëndom mbaron në dëshprim dhe probleme të mëdha. Mashtrimi me fëmijë ka për pasojë edukimin mjaft të keq të pasardhësve, të cilët në mënyrë indiferente sillen ndaj prindërve dhe të afërmeve. Verbëria me pasuri e shpie individin, familjen e tij dhe të afërmit drejt privimit të plotë, nxitë urrejtjen e të tjerëve dhe dëshirën e tyre, që i tilli të bie në varfëri të thellë, të përjetojë nënçmim në këtë botë dhe kujtesë të keqe pas vdekjes. Që njeriu t'i shmanget këtij rreziku, duhet ta ndjek rrugën që e ka caktuar Islami, rruga që nuk e pengon shfrytëzimin e begatave, por ndalon që ato të bëhen gënjeshtër. Kur'ani, pasi që gratë, fëmijët dhe pasurinë i ka quajtur kënaqësi të jetës tokësore, thotë:

“Të devotshmit të Krijuesi i tyre do të kenë kopshtet e xhennetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenjt, në to do të qëndrojnë përherë, edhe gra të pastra, edhe kënaqësinë e All-llahut.” E All-llahu mirë i din obët e Vet, të cilët flasin: “Krijuesi ynë, ne, vërtetë besojmë, prandaj na i fal mëkatet tona dhe na ruaj vuajtjes në zjarr!”... të cilët janë të durueshëm dhe vërtetëdashës, dhe të cilët e kalojnë kohën në lutje, dhe ndajnë lëmoshë dhe të cilët në agim lusin që t'u falet.” (Ali-Imran, 14-17).

Ajetet e theksuara Kur'anore përkujtojnë se ekzistojnë edhe begati më të mira nga këto në këtë botë. Ato janë në botën tjetër, në ahiret, nga dy periudhat ekzistencës. Kur'ani i përmend nga shkaku se njeriu në këtë botë kalimtare, duhet të zotërojë me pasionet e veta dhe mos t'i shndërrojë të mirat siç janë femra, fëmijët dhe pasuria, në epshe, por ato duhet t'i shërbejnë dhe t'i shfrytëzojnë drejt, e jo të bie nën ndikimin e tyre. Atëherë disa nuk do të zhduken me dëfrimet e tepruara, as të tjerët me privimin e pjesërishëm ose të plotë të të mirave të kësaj bote. Këto ajete

Kur'anore, po ashtu, i përmendin edhe cilësitë e atyre që zotërojnë veten dhe nuk u dorëzohen epshëve. Këta janë ata “të cilët ruhen nga të këqijat dhe të shëmtuarat”, ata janë besimtarë të vërtetë, kërkojnë nga All-llahu ﷻ kërkimin e mëkatit, janë të durueshëm, durojnë vuajtje, janë të vendosur në të mirën dhe të keqen dhe vetëveten e kontrollojnë në veprime. Janë të sinqertë në fjalë dhe vepra, përkushtues dhe të nënshtruar lutjes në të cilën e shohin ardhmërinë. I ndihmojnë ata me të cilët e ndajnë të mirën e të keqen dhe gjithënjë janë të gatshëm që t'u dalin në ndihmë. Ata në agimin e hershëm kërkojnë falje nga All-llahu ﷻ, nga arsyeja se jeta e tyre e përditëshme është e rregulluar dhe fillojnë nga mëngjesi me përmendjen e All-llahut ﷻ. Këta, që posedojnë cilësi të këtylla njerëzore të cilat i kanë bërë më të fortë nga ëndjet e tyre, ata janë të vetmit në gjendje që korrektësisht t'i përdorin të mirat e kësaj bote dhe mos të bien në sprovë. Vetëm atyre All-llahu ﷻ u ka premtuar mirë në ahiret, sepse e kanë ruajtur veten nga ekzagjerimi, kurse të tjerët nga privimi i plotë.

JETA E NJERIUT NDËRMJET PUSHIMIT DHE PUNËS

Toka në bashkësi me trupat tjerë qiellor është përgaditur në mënyrën që njeriut t'i bëhet me dije, se jeta e tij e frytshme është në pushim dhe qetësi nga një anë, dhe puna dhe angazhimi, për shkak të ekzistencës dhe vazhdimit të misionit njerëzor, nga ana tjetër. Kjo flet që nevoja e njeriut për

pushim nuk është fare më pak e vlefshme nga nevojat e tij për aktivitetin fizik dhe intelektual gjatë punës.

All-llahu ka krijuar tokën dhe natyrën e jetës në te... Ai, po ashtu, e ka caktuar edhe dualitetin e njeriut në çështjen e pushimit dhe punës. Njeriu sipas natyrës së tij është krijuar për dy gjëra njëkohësisht, për punë dhe pushim. Toka sërish është përgaditur në mënyrën që t'i plotësoj këto dy nevojat e njeriut:

Thua: “Më thuani ju mua, nëse do të jepte All-llahu, që nata t’ju zgjasë amshueshëm, deri në ditën e Gjykimit, cili zot pos All-llahut, do t’ju jepte dritë? Përse nuk dëgjoni?” Thua: “Më thuani ju mua, nëse do të jepte All-llahu, që dita të zgjasë amshueshëm, deri në ditën e Gjykimit, cili zot, pos All-llahut, do t’ju jepte natën, që në te të pushoni? Përse nuk shihni? Nga mëshira e vet Ai u ka dhënë ditën dhe natën, që në te të pushoni, kurse nga të mirat e tij të punoni dhe që të jeni mirënjohës.” (El-Kasas, 71-73).

Kur’ani përmend që ndarja e kohës në natën e errët, kur njeriu qetësohet, dhe në ditën e ndritshme, kur duhet të punojë dhe të jetë aktiv, është begati e All-llahut për njeriun për jetën e tij të kësaj bote, e që nuk ka kush tjetër pos Tij që do të ishte në gjendje që diç të tillë ta bëjë. All-llahu ﷻ më së miri e di ç’është e nevojshme dhe e dobishme, dhe është në gjendje të zbatojë ç’të dojë dhe dëshirojë.

Përfundimi mbi kohën të cilën e nxjerrim nga ky sistem është që njeriu në këtë botë duhet të punojë, që të angazhohet dhe të përpiqet në suaza të mundësive të veta njerëzore me të cilat është krijuar, siç i nevojitet pushimi, qetësia dhe banesa. Ai, prandaj, është përgjegjës para All-llahut nëse e lë pas dore cilëndo prej këtyre gjërave, pushimin në një pjesë të kohës, kurse punës në

tjetrën. Lojaliteti i njeriut ndaj All-llahut ﷻ pikërisht manifestohet në të nënshtruarit e tij ligjeve, sipas të cilave është rregulluar bota, sikur edhe në atë që e kryen, me çka është obliguar ose abstenon nga ajo që i është ndaluar. Si do që këto ajete, mbi rregullimin e jetës njerëzore në tokë ku ndërrohen dita dhe nata, kërkojnë pranimin e ekzistencës së All-llahut, ato po ashtu kërkojnë nga besimtarët që mos të dalin nga suazat e këtij sistemit në jetën e tyre të përditshme. Kohën e caktuar për pushim nuk duhet kaluar në punë, as të lihet pas dore puna duke i lejuar vetes përtaci dhe papunësi, duke u mbështetur në lëmoshë, trashëgimi ose kamatë. Ai që punon pa ndërprerje nuk e kupton domethënien e fjalëve:

“Kush e tepron nuk e lëron tërë tokën, as shpina nuk do t’i mbetet e drejtë. Derisa ai që jeton nga lypësia dhe trashëgimia, pa angazhim dhe punë të ndershme, nuk ka ndjenja për dinjitet njerëzor dhe i humb mundësitë e veta në bisedë të kotë, në lojë dhe në dëm të të tjerëve. I këtyllë nuk është besimtar i cili di për All-llahun ﷻ dhe i cili ndjek rrugën e Tij në këtë botë.”

Ajetet e cituara, po ashtu, theksojnë se nata është për pushim dhe qetësi, kurse dita për angazhim dhe punë, nga shkak i thjeshtë që paqja të sigurohet në kohën të cilën të gjithë njerëzit e marrin për pushim, kurse kushtet e punës janë lehtësuar në periudhën kur të gjithë janë aktivë, sepse drita e ditës i kontribuon atmosferës së punës, deri sa terri i natës, i cili përkujton amshueshmërinë, qetësinë, paqen dhe stabilizimin, pengon.

Kështu, specificiteti tokësor, së bashku me trupat tjerë qiellor me vullnetin e All-llahut trason rrugë të drejtë të ekzistencës njerëzore, ku njeriu i gjenë vend vetes dhe të tjerëve. Nuk orvatet të dominojë natyrën, në gjiun e së cilës është gjetur, para se t’a ketë mësuar rendin dhe ligjin e saj. Nuk ia imponon vullnetin e tij, para se ta marrë direktivën dhe orientimin prej saj. Kur’ani nuk e

izolon njeriun nga natyra as nuk e thërret që mos të depërtojë në fshehtësitë e saj. Përkundrazi, e fton që ta kuptojë krijimin e All-llahut dhe ta harmonizojë jetën e vet me shfaqjet dhe ligjet e saj. Për këtë, njeriu është i obligueshëm t'i falënderohet All-llahut ﷻ në begatitë Kur'anore.

KUR FJALA NUK PËRCILLET ME VEPËR

Besimtarët para betejës në Uhud flitnin për punët që do t'i ndërmarrin pastaj, sepse qenë të sigurtë në fitore. Kështu kjo ishte impuls i entuziazmit dhe gatishmërisë për luftë. Mirëpo, kur entuziazmi u shndërrua në preokupim rreth tubimit të presë dhe materialit të luftës, që e kishte lënë armiku në fillim të betejës, duke ikur para forcës me të cilën u janë kundërvënë besimtarët, ai edhe i ka riorganizuar radhët e veta dhe hyri në kundërsulm duke e shkatërruar forcën për të cilën në fillim u besua se askush asgjë nuk mund t'i bëjë. Rezultati i betejës ka qenë që armiku fitoi, kurse besimtarët humbën. Lidhur me këtë erdhi ajeti Kur'anorë:

“O besimdrejtë, përse e flitni një e tjetër mendoni? O sa u urren All-llahu kur flitni, e nuk punoni! All-llahu i don ata që në rrugën e Tij luftojnë si bedem i fortë.” (Es-Saff, 2-4).

Kur'ani u bën vërejtje besimtarëve për fjalët dhe premtimet e tyre të zbrazëta. Pohon se praktika ka treguar ekzistimin e jazit të gjërë ndërmjet fjalëve dhe veprave, premtimit dhe përmbushjes së tij: “O besimdrejtë, përse e thoni atë që nuk e veproni?” U bën vërejtje për këtë kontradiktë në mënyrën e cila përmban zemërimin dhe pakënaqësinë e All-llahut: “Tek All-llahu gjëja më e urrejtur dhe neveritëse është që ta thoni atë që nuk e veproni.”

Humbja e besimtarëve në Uhud nuk ka qenë katastrofa e vërtetë, në të ka qenë edhe elementi i interesit i cili përbëhej në atë që janë detyruar të ndalen në dobësitë e veta dhe t'i studiojnë shkaqet e këtyre dobësive, në mënyrë që herën tjetër t'i shmangen humbjes, që ta marrin këtë humbje si mësim e cila do t'i shpie deri te fitorja, në rrethanat i imponon lufta e re. Shkak i dobësisë së tyre ka qenë egoizmi dhe rënia nën ndikimin e të mirave të kësaj bote, në momentin kur me fuqinë e tyre dhe me fuqinë e besimit të tyre e përcaktonin fatin e popullit, të cilit i takonin, fatin e ideologjisë dhe misionit të tij. Kthimi i tyre presë dhe pasurisë dhe frikës, duke iu falënderuar solidaritetit të besimtarëve dhe fuqisë së tyre, tregon se konceptcionet e idesë besimin e të cilit e kanë bartë nuk kanë qenë, të paktën, te disa nga ata, më të vlefshme nga kjo botë, dekoreve dhe begatit të saj. Prandaj Kur'ani, pasi morën mësim nga humbja, u drejtohen: “Vërtetë All-llahu i don ata që luftojnë në rrugën e Tij në radhë të forta sikur ata të jenë mur që është fuqishëm i lidhur dhe i ngjitur.” Rruga e fitores në jetë, rreziqet, kujdesi, lufta... është në këmbëngulësinë dhe pathyeshmërinë në kryerjen e detyrave, ashtu që duket se të gjithë luftojnë për gjënë e njëjtë, në një rresht ku nuk ka zbraztirë: “Vërtetë All-llahu i don ata që luftojnë në rrugën e Tij në radhë të forta.” Krahas kësaj duhet llogaritur edhe për konsolidimin e të gjitha forcave disponuese para takimit dhe konfliktit: “sikur ata janë mur që është fuqishëm i lidhur dhe i ngjitur.” Fitorja, siç shihet nga ky ajet, është kushtëzuar me momentin vijues: që lufta që bëhet, të jetë në rrugën e All-llahut, në rrugën e vlerave dhe parimeve të larta morallo-etike, të cilët njerëzimit i garantojnë të mirën, fuqinë, lavdinë, raportet e shëndosha reciproke dhe solidaritetin, kurse i shmangen imponimit të vullnetit të tjetrit me pranimin e obligimeve pa hamendje dhe dyshim, dhe më në fund ballafaqimin me fatkeqësitë dhe rreziqet të përbashkëta me forcat, rradhët e të cilave janë të qëndrueshme dhe të forta. Paralajmërimet e humbjes janë: Shumë të folur mbi punën, së cilës nuk i qaset me mjaft sinqeritet dhe vendosmëri dhe shikimin në anën

materiale të jetës dhe kënaqësitë e tij, në çastin kur janë në pyetje vlerat dhe parimet e larta moralo-etike.

Tregimi mbi punën, së cilës nuk i qaset vendosmërisht, jo vetëm që është humbje e besimit në atë çka thuhet, por shpie edhe në thyrjen e ambicjeve personale të cilat personi rëndom ia vë vetes për detyrë. Në të vërtetë, mbejta pas e veprave pas fjalëve është mashtrim i vërtetë dhe rregullisht, manifestohet negativisht në individë, deri sa gradualisht nuk e përfshin edhe tërë popullin dhe paraqet rrezik për ekzistencën e tij. Shumë premtime, nga të cilat mjaft pak plotësohen, dëfrenjë dhe fitohet ndjenja e trimërisë në fillim. Mirëpo, me pasojat e veta, ato janë katastrofë e vërtetë për kombin dhe ardhmërin e tij, sepse dyshimi bëhet i domosdoshëm dhe pjesa përbërëse e tërë asaj që thuhet, e madje edhe ftesës së sinqertë për evitimin e rrezikut real, i cili do ta shkatërrojë kombin në tërësi, nëse e godet.

Për këtë besimi në vlerat e larta morale dhe besimi në All-llahun ﷻ është gjëja e parë e cila kërkohet, pastaj qëllimi i sinqertë që sërish është produkt i besimit të fuqishëm, pastaj aksioni me forcat e përbashkëta dhe vetëm atëherë tregimi mbi suksesin me ndihmën e All-llahut, e jo të folurit mbi humbjen, thyerjen dhe jorehatinë.

NUK KA SHPËRBLIM PA SPROVA

1. Problemi i besimit në vlerat e larta morale dhe në All-llahun ﷻ nuk është çështje e gjuhës se si do ta shprehni më bukur, as luks me të cilin njeriu kënaqet, e nuk është as dekor që e zbukuron.

Ky është problem i jetës së njeriut në themel dhe në tërësi. Rruga e fesë është e mundimshme. Pengesat e saj janë të shumta dhe të rrezikshme. Jeta e besimtarëve është vetëm provim dhe varg i pandërprerë i sprovave, të cilat shpesh ia trondisin shpirtin që ndonjëherë e shpicejnë në dëshprim:

“A mendoni ju, se do të hynë në xhennet, e ende nuk e keni shijuar atë që e kanë shijuar ata, të cilët para jush kanë qenë dhe zhdukur? Ata i kanë dërmuar mospasjet dhe sëmundjet, dhe aq qenë shqetësuar, që edhe i dërguair edhe ata që kanë besuar me ta, kanë bërë titur: “Kur do të vijë më ajo ndihma e All-llahut?” Ja, ndihma e All-llahut është vërtetë afër!” (El-Bekare, 214).

Besimtari i është ekspozuar urisë, skamjes, ofendimit, dëmeve, sëmundjeve, jorehatisë dhe jostabilitetit: “Ata i kanë shfarosur skamjet dhe sëmundjet.” Nga kjo nuk është kursyer as i dërguari, as ideologu as besimtari, nga afërsia as nga largësia dhe goditjet e mëdha i kanë gjetur që edhe i dërguari edhe këta që me të kanë besuar kanë bërë titur: “Kur do të vijë më ajo ndihma e All-llahut?”

Lënia e besimtarit në All-llahun ﷻ dhe vlerave të larta morale në mëshirë dhe jomëshirë të këtyre provokimeve, nuk është karakteristikë e një kohe, as e një misioni të të dërguarit të caktuar, as vendit të lidhur për këtë apo atë shpallje. Ky është parimi kryesor i ekzistencës njerëzore, një nga ligjet që e rregullojnë shoqërinë e tërësishme njerëzore me të gjitha këto shfaqjet e tij të nduarnduarta: “A po mendoni ju se do të hyni në xhennet, e mbi kokat tuaja ende nuk ka fryrë ajo që ka kaluar mbi ata që kanë qenë para jush.” Skamjet, ofendimet dhe dëmet, të cilave besimtari në All-llahun ﷻ u është ekspozuar, janë të natyrës materiale. Këto kokëçarje nganjëherë zgjasin më shumë, apo pasojat u janë aq të rënda sa që njeriu fillon të hamendet ndërmjet

kokëçarjes së cilës i është ekspozuar dhe shpresës në ndihmën e premtuar të All-llahut: “dije se ndihma e All-llahut është afër.” Kur njeriu të jetë i sigurt në ndihmën e All-llahut, e kjo duhet të jetë nëse udhëhiqet sipas parimeve të fesë, atëherë skamja së cilës i është ekspozuar është e parëndësishme, i kthehet qetësia dhe forcohet shpresa në fitore kur do kënaqet në të mirat, e kësaj bote. Nga ana tjetër, nëse besimtari lehtë e duron skamjen dhe sakrificat materiale në emër të fesë së vet, ndihet fitimtar, krenar dhe i madh, që edhe kjo është një pjesë e ndihmës së All-llahut ndaj tij. Dallimi ndërmjet territ, dëshprimit dhe dritës së shpresës është dallimi i karakterit psikologjik. Atë njeriu mund ta tejkalojë me durimin e besimtarit të vërtetë dhe me mbështetjen në All-llahun ﷻ. Sado më shumë që e shkel nuk i kthehet sërish territ, sepse kjo vetë shpërndahet me vdekjen e tij. Kështu kalon në shfrytëzimin e fitores së amshueshme dhe ky është fundi i eksperimentit dhe sprovës. Fitorja e vërtetë të cilën e përjeton besimtari është takimi me All-llahun ﷻ, amshueshmëria në xhennet dhe kënaqësia e All-llahut.

2. Nëse njeriu nuk armatoset me besimin në All-llahun ﷻ rrallë herë arrin ta zgjidhë ndonjë nga problemet, të cilat nga shkaqet e ndryshme ia imponojnë telashet jetësore. Shpesh ky shkak nuk është provokim i besimit të tij, nganjëherë këta janë vetë kushtet e jetës dhe rethanat e saj të cilët vazhdimisht ndërrohen. Ndërkaq, shkaqet e ndryshimit të rrethanave dhe kushteve natyrore, si i kupton njeriu, deri më sot, nuk kanë fituar karakterisitika të përgjithshme, sepse anëtarë i familjes, i shoqërisë dhe i kombit nuk është i edukuar ashtu që krizat dhe ekspozimi i njeriut atyre, të jenë shfaqje e domosdoshme për jetën grupore. Prej aty është edhe humbja e shpresës gjatë kundërvënies rreziqeve, shkak i trishtimit të jetës, dëshprim atij që mbi ta nuk vigjëlon. Për këtë besimi në All-llahun ﷻ nuk është aq çështje personale e individit sa është problem i shoqërisë dhe kombit si tërësi, i cili synon ekzistencën, konsolidimin, lavdinë dhe mirëqenien.

LUTJA AFRON TEK ALL-LLAHU ﷻ

Qëllimi i të gjitha këtyre lutjeve, namazit, agjërimit, zekatit dhe haxhit është të të afrojnë kah All-llahu ﷻ nga arsyeja se krijojnë atmosferë në të cilën besimtari, duke u vetmuar dhe duke i harruar problemet e kësaj bote, e kujton Zotëriun e tij dhe ku fuqia dhe madhështia e Tij i bëhen më të afërta. Në këtë rast, kur fuqia dhe madhështia e All-llahut janë të pranishme, besimtari synon që të jetë afër attributeve të All-llahut. Nëse lutja është e domosdoshme që me All-llahun të vihet në kontakt dhe t'i drejtohet Atij, atëherë ajo duhet edhe të përcillet me praninë, e cila nuk është e karakterit hapësinor. Në të vërtetë, duhet që All-llahu me atributet që i përshkruhen Atij të gjendet në jetën e njeriut, e kurrësi i izoluar as i ndarë nga jeta e tij. Besimtari i devotshëm duhet të përpiqet që çdo moment në personalitetin e vet t'i senërtojë atributet që i përkasin All-llahut ﷻ: dija, fuqia, jeta, forca, mëshira, krijimi, trajtësimi, pasuria dhe të gjitha të tjerat, të cilat janë pjesë e qenies së Tij. Kjo nuk do të thotë uniteti i All-llahut ﷻ me njeriun ose anajelltas, si e mendojnë këtë disa mistikë. Kjo pikërisht d.m.th. që njeriu i devotshëm komunikon me të tjerët duke u udhëhequr gjatë kësaj me atributet e All-llahut, i përvetson ato dhe i posedon në masën që me to drejtohet. Për këtë nxiton për dije, sa më i pasur të jetë me të dhe sa më shumë ta njohë ekzistencën complete dhe specificitetet e saj, madje edhe All-llahu ﷻ është aq më afër Atij. Përpiqet të bëhet i fuqishëm dhe i aftë, ta posedojë fuqinë e trupit, aftësinë e arsyes, dhe gjykimin, mundësinë e sundimit mbi pasionet dhe aftësinë e planifikimit në jetë. Sa të jetë në gjendje që sa më shumë të ketë nga këto të gjitha në vete, aq është më afër All-llahut ﷻ. Synon që shpirtit të tij

t'i zhvillojë jetë fisnike dhe ta largojë nga e shëmtuara dhe ulëta, jeta me plotë liri individuale që është karakteristike e tij. Përpiqet që shpirtërisht të pasurohet, me anë të maturisë dhe kënaqësisë, me ato që janë më të domosdoshme dhe përveç mundësisë që të arrijë shumë më tepër nga kjo. Pasuria e All-llahut nuk përbëhet nga pasuria dhe pasardhësit, por në atë që askujt nuk i nevojitet që përherë të ekzistojë. Për këtë njeriu nuk mund t'i afrohet All-llahut ﷻ i cili është aq i pasur, me grumbullimin e pasurisë, por me maturi në të, as me shumësinë e fëmijëve, por me mospasjen e nevojës për ta. Sado që besimtari i devotshëm pavarësohet nga pasuria, nderi dhe pushteti, aq është më afër pasurisë së All-llahut dhe nuk ka nevojë për asgjë pos për Të. Besimtari me anë të punës dhe aksionit krijon dhe trajton. Është specialist i punës së vet dhe e kryen me ndërgjegje. Cilësia është kriter i tij, e jo sasia, sepse puna cilësore është edhe produktive. Kështu puna e misionarit është e përsosur, vetëm nëse le gjurmë të dukshme tek ata që i udhëzon. Puna e profesorit do të fitojë karakteristikën e kreativitetit nëse nxënësit dhe studentët i orienton drejtë, më parë me shembull të mirë se sa me ligjëratë. Dhe specialist sa më i madh të jetë në punën e vet dhe ta kryejë me ndërgjegje atë, aq është më afër krijimit dhe kreturës së All-llahut. I këtilli është i mëshirshëm me besimtarët e drejtë, edhe atëherë kur është më i rrepti ndaj kundërshtarëve të së vërtetës dhe armiqve të humanitetit, të cilët njëri tjetrin e konsiderojnë për idhull dhe adhurohen për një periudhë të caktuar, kurse kur e humbin shenjtërinë kalojnë në të tjerët dhe kështu jeta u kalon në ngritjen e idhujve dhe në adhurimin e përkohshëm. Sa më i afërt dhe i mëshirshëm të jetë besimtari ndaj besimtarëve tjerë, kurse më i rreptë ndaj armiqve të së vërtetës, është gjithnjë e më afër All-llahut ﷻ i cili është i mëshirshëm dhe jopërdëllues në të njëjtën kohë.

Mirëpo, nëse lutja izohet nga orvatja e përshkrimit me atributet e All-llahut, dhe nuk bëhet iniciatore e njeriut, ideologjike dhe praktike, vlera e saj bie dhe gjurma pothuaj nuk i ndihet. Në këtë kuptim Kur'ani thotë:

“Kurse kontributet e tyre nuk do të pranohen për shkak se nuk besojnë në All-llahun dhe në të Dërguarin e Tij, që plogsh të kryejnë lutjen dhe që vetëm jashtë vullnetit ndajnë.” (Et-Tevbe, 54).

I përshkruan hipokritët dhe thotë se lutja u është joproduktive. Përtacia, me të cilën falen, dhe detyrimi me të cilin e shpenzojmë pasurinë përdhën në izolimin e lutjes së tyre, e kjo është karakteri i saj impulsiv në jetën e besimtarit të vërtetë. Për këtë ata edhe e besojnë All-llahun ﷻ dhe të Dërguarin e Tij me besim të sigurtë. Kur'ani për qëllimin e namazit thotë:

“Komunikoje Librin që po të shpallet dhe kryeje namazin-vërtetë namazi pengon nga shfrenimi dhe nga çdo gjë e keqe; kryerja e namazit është dëgjueshmëria më e madhe!-dhe All-llahu e di çak punoni.” (El-Ankebut, 45).

Konfirmon që lutja e vërtetë ka rezultate pozitive, prandaj pasojat e faljes janë lënia e shfrenimit dhe së keqes, shmangia nga kundërvajtjet shoqërore dhe morale, të cilat ofendojnë dhe i dëmtojnë të tjerët. Në të kundërtën, nëse ky pozitivitet nuk bëhet rezultat konkret i namazit, atëherë ai është formal, dhe si i këtillë nuk përdhë në ekzistencën e All-llahut ﷻ në cilësi të faktorit aktiv në jetën e njeriut. Falja në këtë mënyrë është vetëm ceremoni, formë dhe figurë pa shpirt dhe gjurmë.

Në nga shenjat e dobësisë së muslimanëve është edhe izolimi, për të cilin është këtu fjala. Për këtë, ata janë të barabartë me ata që tërësisht e kanë braktisur namazin dhe i kanë përqafuar

epshet. Dhe atë ditë kur të bëhen të fortë me trup dhe intelekt, kur të kujdesen për arritjen e dijes, të jenë të ndërgjegjshëm në punë, kur ta ndjekin rrugën e Kur'anit në sjellje, singërisht dhe vëllazërisht komunikojnë njëri tjetrin, vetëm atëherë edhe në lutjet e veta do të jenë në shkallën e caktuar të afërsisë me All-llahun ﷻ, i cili u mundëson të bëhen “populli më i mirë”. Besimtari i fuqishëm është në afërsi të All-llahut, sepse i posedon cilësitë të cilat janë specifike vetëm për Krijuesin, deri sa besimtari i dobët është larg nga All-llahu ﷻ për shkak të attributeve të këqija të cilat i përshkruhen.

JETA E TË DËRGUARIT TË ALL-LLAHUT -MISHËRIM I MISIONIT TË TIJ

Skenat e shumta nga jeta e të Dërguarit të All-llahut, ashtu si edhe ato që janë në lidhje me pejgamberinë e tij, i kanë kontribuar suksesit të misionit, me të cilin është ngarkuar. Këto shfaqje në sjelljen e tij e shprehin në të vërtetë biografinë e vërtetë të koncepcioneve, pas të cilave kanë qëndruar edhe një varg synimesh që e shpiejnë njeriun, i cili beson në to, në humanitetin e lartë, humanitetin që e përcjell moralin dhe bëmirësinë konstruktive.

Kur Kur'ani i regjistron aspektet si këto, në kuptim të premtimit dhe udhëzimit drejt të Dërguarit të All-llahut, ai dëshiron vetëm të theksojë se përtërirja e apelit kah e vërteta ose çfarëdo apeli tjetër qëllimi i të cilit është shkalla më e lartë e humanitetit - nëse rrethanat shoqërore janë të atilla

që të kërkojnë dalje nga rënia morale, duke kërkuar ideolog, i cili do ta spjegojë udhëzimin konkret të privuar nga çdo qëllim tjetër dhe nga aspiratat personale - e ky është udhëzim i All-llahut dhe rruga e drejtë - nuk do të ketë kurrfarë rezultatesh pozitive nëse pranë tij nuk gjenden fenomenet që i kërkon Kur'ani, me të cilat All-llahu ﷻ e ka udhëzuar të zgjedhurin Muhammed (ﷺ) të birin e Abdullahut.

Sa u përket epsheve dhe udhëzimeve kur'anore të drejtuara drejtpërdrejt të Dërguarit të All-llahut, ata vlejné për të gjithë besimtarët, gjatë gjitha kohëve dhe brezave, dhe ata duhet patjetër të pranohen dhe të aplikohen në rrethanat dhe situatat shoqërore, të cilat i përgjigjen rrethanave të shpalljeve të tyre. Fenomeni më i rëndësishëm i pasojave të dukshme të cilat garantojnë suksesin e misonit dhe apelit janë:

-që ajo në çka ftohet të paraqes të vërtetën e njëmendët;

-lojalitetin e plotë ndaj kësaj;

-zbatimin korrekt të parimeve pas të cilave qëndron në jetën vetjake.

1. Domosdoshmëria e së vërtetës në zbatimin e njëmendësisë së asaj që rekomandohet kërkon gjithsesi edhe largimin e tij nga e pavërteta dhe mashtrimi. Për këtë All-llahu ﷻ i thotë të Dërguarit të Vet:

“Thuaj: unë nuk ju them juve: tek unë janë thesaret e All-llahut, as nuk ju them: Unë jam engjull-unë ndjek vetëm atë që më shpallet. “Thuaj: “A janë të njëjtë i verbëri dhe ai që sheh? Përse nuk mendoni?” (El-En’am, 50).

Ajeti paralajmëron tri gjëra gjatë thirrjes, prej të cilave secila është në gjendje të mundësojë dhe tërheq ithtarë dhe aspirantë në periudhën e caktuar, duke pasur në mend se kthimi prapa, pasi të zbulohet realiteti, është shumë më i rëndë dhe shndërrohet në faktor rrënues të thirrjes origjinale. Tërheq vëmendjen se nuk është fjala për premtimin e pasurisë së vëllimshme dhe dhënies, sepse pritët nga ai që pohon se ka pasuri dhe se ndan vazhdimisht, pandërprerë. Po ashtu, paralajmëron se nuk flitet për njohjen e fshehtësive, ngase ka qenë njohur tek Arabët, tek falltorët dhe astrologët e tyre, se njohja e fshehtësive mundëson kërkimin e të mirave materiale. Për këtë, apeli pas të cilit qëndron propaganduesi që pohon se i di fshehtësitë, do të pranohej, por nën ndikimin e kënaqësive të kësaj bote e cila me vete bartë të nesërmen më të mirë për shkak të njohjes së asaj që do të ndodhë:

“E sikur e keqja do të ishte larg nga unë.” (El-A’raf, 188).

Dhe më në fund, ajeti paralajmëron në pretendimin që ka pikëpamjen se njeriu është jashtë suazave të mundësive njerëzore, se është lloji që nuk posedon anën animale as ofertën, dhe se për këtë arsye është më i zgjedhur, për ç’arsy duhet t’i përulemi kur prinë dhe udhëheqë:

“Por prijësit e popullit të tij, që nuk kanë besuar, kanë folur: “Ky është njeri bash sikur edhe ju, vetëm dëshiron që jasht jush të dallohet. Sikur të dojë All-llahu, do të dërgonte engjëj. Kështu diç nuk kemi dëgjuar nga stërgjyshërit tanë të lashtë.” (El-Mu’minun, 24).

“Por krerët e popullit të tij, që nuk kanë besuar, të cilët kanë mohuar se në këtë botë do të ringjallen, dhe të cilëve u kemi dhënë që në këtë botë në luksoz të jetojnë, do të thonin: “Ai është njeri sikur edhe ju, ai hanë atë që edhe ju hani, dhe pinë atë që edhe ju e pini. Dhe nëse i nënshtrohemi njeriut, sikur që jeni edhe ju, sigurisht do të humbeni.” (El-Mu’minun, 33-34).

Ajeti pos kësaj kërkon nga i Dërguari i All-llahut që me shprehje të qartë e precize ta ekspozojë detyrën e misionit të tij: “Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur.” Në të vërtetë, folë dhe transmeton vetëm atë, asgjë mos shto, siç është kjo traditë që vetëm të nxitet, pranimi i cili më së shpeshti është i karakterit të përkohshëm dhe pasojat e të cilit pastaj nuk mund të shmangen.

2. Në nevojën e sinqeritetit dhe lojalitetit të plotë të gjërave, në të cilat apelohej tregon Kur’ani kur e thërret të dërguarin e All-llahut:

“Thuaj: “Namazi im, falja ime, edhe jeta ime, edhe vdekja ime, vërtetë i janë përkushtuar All-llahut, Krijuesit të botërave, i cili nuk ka të barabartë me Vetën. Kjo më është urdhëruar, dhe unë jamë muslimani i parë.” (El-En’am, 162-163).

Misioni i të dërguarit është të thërrasë në udhëzimin e All-llahut. Për këtë arsye sinqeriteti i plotë ndaj All-llahut ﷻ edhe përbëhet nga ajo që tërë jeta e bartësit të misionit të jetë lutje dhe drejtim Krijuesit. Jeta e tij, në të vërtetë, është shembull që përmban parime të thirrjes pas së cilës qëndron. Ai duhet të jetë shembulli i parë i besimtarëve, si sipas besimit në ato konceptione, ashtu edhe sipas aplikimit të në praktikë.

3. Faktori i qëndrësës dhe durimit sipas rëndësisë së tij aspak nuk mbetet prapa dy kushteve paraprake, të cilat shpiejnë kah apeli i suksesshëm drejt së vërtetës, për çka flet edhe Kur’ani:

“Prandaj praktikisht komunikojë atë që të urdhërohet dhe mos ua vë mendjen politeistëve; Ne do të çlirojmë nga ata që tallen, të cilët pos All-llahut zot tjetër marrin dhe do të marrin vesh ata! Ne mirë e dijme, se e ke rëndë në zemër për atë çka ata flasin, prandaj madhëroje Zotriun dha lavdoje

Atë, dhe bënu prej atyre që bëjnë sexhde, dhe deri sa je gjallë, Krijuesin tënd adhuroje.” (El-Hixhr, 94-99).

Këto ajete kërkojnë qëndresë në mision dhe në shpalljen e tij përkundër pakënaqësisë së kundërshtarëve të tij, të cilët me qëndrimin e tyre i pengojnë bartësit e së vërtetës. Përveç kësaj qëndrese ata ende kërkojnë edhe aplikimin praktik të pandërprerë të parimeve të këtij misioni në jetën e bartësit të tij, posaçërisht të namazit, pa frikë nga kushdo, deri në frymën e fundit.

4. Kur këtyre tre faktorëve, vërtetësisë së misionit, lojalitetit ndaj saj dhe qëndresës në të, u shtohet aplikimi i drejtë, që në fakt jep fotografinë e njeriut fisnik i cili pranon konceptonet për të cilët thërret, atëherë edhe suksesi i misionit është i garantuar. Në këtë jep shenjë Kur’ani:

“Ti shko rrugës së vërtetë, sikur që të është urdhëruar, e ashtu le të veprojnë edhe besimtarët të cilët janë me Ty, dhe mos u bëni të vrazhdë, sepse Ai sheh shumë mirë atë që ju punoni, Dhe mos e mbani anën e atyre, që padrejtësisht veprojnë, e që t’ju djeg zjarri, ju nuk keni mbrojtës tjetër, pos All-llahut, përndryshe, nuk ka ndihmë për ju! Dhe kryeje namazin në fillim dhe në fund të ditës dhe në kohët e kërkuara të natës! Veprat e mira vërtetë i zhdukin veprat e këqija. Kjo është mëshirë për ata që e duan mësimin. Dhe bëru i durueshëm! All-llahu, pa dyshim, nuk do t’ua mungojë shërblimin atyre, që vepra të mira bëjnë.” (El-Hud, 112-113-5).

Ajetet e cituara kërkojnë nga i dërguari i All-llahut dhe nga ata që në të besojnë ta ndjekin atë që iu porositet:

-që mos t’i nxisë periudha e suksesit të misionit të tyre në tirani dhe të konsiderohen më të mëdhenj se të tjerët,

-që mos të kenë besim në ata që janë në lajthithje dhe të cilët me mosbesimin ndaj All-llahut ﷻ i bëjnë vetes dhunë, dhe mos t'i pranojnë këshillat e tyre as mos t'i imitojnë, sepse mund t'i godasë shkatërrimi,

-që mos ta praktikojnë hakmarrjen, por të reagojnë në sjelljet dhe veprimet e armiqësisë të tyre në mënyrën si e bëjnë këtë njerëzit me vlerat të larta morale,

-që të bëhen të durueshëm kur t'i shqetësojë dikush ose u shkaktohet dëm,

Kjo është mjaft për sukses dhe shpëtim, sidomos nëse All-llahu ﷻ është i pranishëm në përmendje në të gjitha çastet e tyre që i kalojnë duke punuar.

Tërë kjo që realizon dhe që bën realitet në jetën e të Dërguarit të All-llahut, gjatë pejgamberisë së tij dhe në raport me të tjerët, e Kur'ani thotë:

“Kush i përulet Lajmëtarit, ai edhe All-llahut i është përuhur, duke krijuar nga jeta e vet mishërim të misionit me të cilin qe ngarkuar.”

Për këtë arsye edhe kremtimi i ditëlindjes së të dërguarit të All-llahut duhet të jetë në shenjë të ndjekjes së rrugës së atij, i cili ka ftuar në rilindje, i ka vendosur dispozitat dhe i cili në personalitetin e tij e ka unjtësuar këtë dhe botën tjetër.

FALJA E NAMAZIT TË XHUMASË NUK E NDËRPRET FURNIZIMIN

Kur është koha e namazit të xhumasë, e njeriu gjendet në punë, mund të hamendet që mos të përgjigjet në thirrje të ezanit dhe të shkojë në xhami, duke llogaritur se koha për të cilën falet namazi i xhumasë nuk është si në namazet tjera, sepse është diç më e gjatë. Përveç kësaj, falet pikërisht, në gjysmë të ditës, kur puna e përditshme është në vllgun më të madh, dhe se lëshimi i tij do të shkaktojë humbje, sikur që nganjëherë njeriu flet me hamendje se agjërimi zvogëlon aktivitetin e punës apo se zekati i zvogëlon të ardhurat.

Namazi i xhumasë ka rëndësi të lutjes dhe rëndësi të manifestimit të saj të përbashkët në të njëjtën kohë. Ai është tubim, ku besimtari pa tjetër duhet t'i përtrijë lidhjet me vëllezërit e vet në situatën të cilën e përcjell mosekzistimi i dallimeve ndërmjet të pasurit dhe të varfërit, autoritativit dhe të rëndomtut, sikur që humben dallimet edhe në vete, ngjyra dhe të tjerat, që e ndajnë një person nga tjetri. Në të vërtetë në këtë tubim sundon vetëm synimi i drejtimt All-llahut ﷻ dhe besimi në Të. Atmosfera e këtyre e pastron jetën njerëzore nga jorehatia e vrapit për dëfrimet materiale, së paku deri sa zgjat namazi. Gjurmat e tij ndihen një kohë të caktuar.

Xhumaja në të vërtetë është mbledhje ku kristalizohet jeta e shitblerjes të anëve të interesuara dhe ua kthen besimin në solidaritet dhe ndihmesë gjatë kontaktimit dypalësh. Ju tërheq vërejtjen në qëllimin e tyre më të lartë, qëllimin e vëllazërimit të përgjithshëm njerëzor sipas Librit të All-llahut, tërheq vërejtjen në pranimin e tij, veprimin sipas tij dhe ruajtjen e tij.

Ai është takimi i përmbushur me dashuri ndaj All-llahut ﷻ dhe me mbështetjen vetëm në të për angazhimin dhe punën e dhënë: “Kush mbështetet në All-llahun, Ai i mjafton atij”, që të ketë sukses në mendimin dhe qëllimin e vet. Për këtë xhumaja është ku çdokush merr pjesën e vet, sa të përtëritet individi me këtë takim aq është edhe pjesa e saj në të. Kur të merret krejt kjo parasysh, është i kuptueshëm edhe apeli kur’anor i drejtuar besimtarëve:

“O besimdrejtë, kur të thirreni për namaz ditën e premte, lereni shitblerjen dhe shkoni që All-llahun ta përmendni, kjo dinie, është për ju më mirë.” (El-Xhumuatu, 9).

Kërkon të nxitojnë në xhami që ta lavdërojnë All-llahun ﷻ për ta lënë shitblerjen, kurse ky është simbol për lënien e çdo pune i cili është burim i furnizimit. Pastaj shpjegon se ajo që kërkohet prej tyre, që ta lënë punën gjatë kohës së namazit të xhumasë dhe të shkojnë në namaz, është në fakt më mirë për atë që i përgjigjet. Që besimtarët mos ta kuptojnë gabimisht që ndërprerja e punës të premtën gjatë kohës së namazit të xhumasë është festë edhe dita e mbetur, ekziston ajeti i cili i qorton që ta vazhdojnë punën posa të falen:

“Ndërsa kur i kryhet namazi, atëherë shpërndanu nëpër tokë dhe begatinë e All-llahut kërkonie dhe All-llahun përmendne shumë, që të arrini çka dëshironi.” (El-Xhumuatu, 10).

“Dhe përmendni All-llahun shumë”, d.m.th. që gjithmonë, deri sa punojnë dhe angazhohen, ta kenë në kujtesë udhëzimin, e All-llahut në rrugën e drejtë, e cila është caktuar gjatë kontakteve të ndërsjella, kryerjes së punëve ose aktiviteteve përgjithësisht. Të këtuillët vijnë deri te furnizimi vetëm në mënyrë të lejuar, por edhe i shpenzojnë korrektësisht. Hallalli dhe harami u janë të qartë, çdo gjë që e dëmton individin dhe të tjerët është e ndaluar, deri sa të tjerat janë të lejuara.

Besimi, prandaj, është lehtë i kuptueshëm. Në të nuk ka kurrfarë komplikimi. Kurse lutja, pa dallim lloji, i kontribuon fuqisë shpirtërore, e cila i nevojitet personit, gjatë punës dhe produktivitetit të tij, më tepër cilësor se sasior. Ajo nuk është vendosur për shkak të vërtetimeve të rëndomta, as ta luftojë njeriun nga aksionet jetësore.

MUHAMMED EL-BEHIJ

- JETA DHE VEPRA SHKURTIMISHT -

1. Bota muslimane në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX karakterizohet me batica dhe zbatica të mëdha ushtarake politike, socio-ekonomike nga një anë dhe shkencore, kulturore e civilizuese nga ana tjetër. Njëherësh kjo periudhë shënon shenjat e para vendimtare të muslimanëve për heqjen e kolonializmit dhe dominimit të huaj shirtëror e territorial, dhe frytet e para konkrete të mësuesve të mëdhenj: Ibni Tejmije, M. Abdulvehabi e etj. Angazhim të madh në këtë kanë dhënë Xh. Afgani, M. Abduhu, A. Kevakibi, A. Hani, R. Rida, F. Vexhdi, Sh. Numani, E. Azadi, M. Ikbali e të tjerë, secili në fushën e vet.

Një nga nxënësit e kësaj plejade gjigantësh, i drejtpërdrejtë apo tërthorazi, është edhe egjiptiani, akademiku Dr. Muhammed El-Behij.

2. Dr. Muhammed El-Behij u lind para 90 vitesh më 1905 në Egjipt. Mësimin fillor dhe të mesëm e kreu në qytetin e Aleksandrisë. Si edhe shumë fëmijëve dhe familjeve të asaj kohe, iu plotësua dëshira që të regjistrohet në Universitetin e njohur muslimanë të Kajros në “El-Ehzer”. Pasi i kreu me sukses studimet, si studenti më i dalluar fitoi bursën nga fondi “Muhammed Abduhu” dhe shkoi të studjojë në Gjermani. Atje regjistroi dhe e kreu edhe një fakultet tjetër. Më pastaj,

studimet i vazhdoi si postdiplomist dhe kështu në vitin 1936 doktoroi në filozofi, në Universitetin e Hamburgut. (M. Hafizofiq, “Vjerovanje u Boga ﷻ”).

Arsimimi i tij tradicional (në “El-Ez’herin” e reformuar nga M. Abduhu...) dhe modernistët perëndimorë në Evropë, studimi i shkencës së idealizmit gjerman, socialutopizmit francez, pastaj ekzistencializmit dhe materializmit ateist, bën që M. El-Behij të absorbojë dituri të shumta dhe njëherësh ndikuan që të formojë kritere të rrepta dhe metoda origjinale në punën e tij intelektuale, kërkimore dhe shkencore. Kjo u manifestua edhe në punën e tij praktike, pasi u kthye nga Evropa në Egjipt, ku punon si profesor i filozofisë në Univerzitetin e El-Ez’herit, disa vite. Si rezultat i punës së tij kemi paraqitjen e dijes.

3. M. El-Behij brenda një kohe relativisht të shkurtër u dallua me punën e tij. Kjo ndikoi që të tërheqë vëmendjen e kompetentëve dhe të caktohet drejtor i Sektorit kulturo-arsimues të Universitetit të El-Ez’herit, e më pastaj të emërohet edhe doktor i tij. Edhe në këtë funksion, M. El-Behij ishte i palodhshëm dhe mjaft produktiv. Mirëpo, punën më të madhe M. El-Behij do ta zhvillojë vetëm pasi u emërua ministër i Vakufit dhe çështjeve të El-Ez’herit. Në këtë post, ai, sipas shembullit të mësuesve të mëdhenj, do të jep kontribut të jashtëzakonshëm për Universitetin në fjalë dhe për mbarë botën muslimane.

Me mësimin e tij, u nxorr Ligji mbi reformat në El-Ez’her, të cilat Universitetin e riorganizuan në formë dhe përmbajtje, në sasi dhe në cilësi. Ligji i ri i solli freski dhe prosperitet të theksuar. U themeluan të gjitha fakultetet e nevojshme, pa marrë parasysh drejtimin, lëndë obligative ishin: Akaidi, (besimi), tefsiri (Egzegeza), hadithi (tradita) dhe fikhu (jurisprudenca). Fakultetet specifike kanë mësuar lëndën përkatëse Islame.

Këto reforma e ngjallën punën, angazhuan, potencialet krijuese dhe El-Ez’heri filloi sërish të emitojë shpirt dhe frymë të shëndoshë. (Shih: F. Rahman, “Duh Islama”, fq. 267-341).

Ky ligj, po ashtu, mundësoi edhe hapjen e fakultetit për femrat muslimane. Më vonë, në vitet e 70-ta ky fakultet u riorganizua në Univerzitet të veçantë, që për mbarë botën muslimane ka një rëndësi të madhe.

Shpirti i tij kreativ, fuqia e tij intelektuale dhe autoriteti i tij prej punëtori të zellshëm, e motivuan që t’i rreket edhe një pune shumë me rëndësi. Ky ishte mision për organizimin dhe themelimin e trupit më të lartë shkencor të botës muslimane “Akademia e shkencave Islame” të El-Ez’herit, për anëtarë të së cilës mund të zgjidhen mendimtarët, shkencëtarët dhe krijuesit më të mëdhenj Islamikë.

Akademia ka mekanizmat ordinarë dhe mbarë seancat e veta të rregullta. Në të studimi shqyrton dhe analizon problemet poetike Islame dhe sjell vendime përkatëse përkitazi me çështjet e pazgjidhura nga aspekti kur’anoro-sunnetik e shkencor, që i preokupojnë dhe me të cilat ballafaqohen të gjithë muslimaët e botës gjatë jetës dhe punës.

Këto ishin të dhëna të shkurtëra për disa nga aktivitetet kryesore të tij në aspektin e organizativo intelektual, ku M. El-Behij ishte bartësi dhe ideologu i tyre, orientues brilant dhe konstruktiv, kreativ dhe perspektiv.

4. M. El-Behij është filozof e mendimtar mjaft produktiv. Në çastin kur po e shkruajmë këtë shkrim rasti nuk disponojmë me të dhëna të plota bibliografike për të, por edhe kjo e afuara mjafton të shihet opusi i tij në planin e fjalës së shkruar. Si njohës i mirë i Orientit dhe

Perëndimit, ai u ballafaqua me shumë çështje për të cilat duhet dhënë zgjidhje; prandaj ai shkroi në zhanre të ndryshme. Veçori e shkrimeve të tij është se ai përpiket burimisht ta kuptojë problemin dhe në mënyrë origjinale të interpretojë si besimin Islam, ashtu edhe problemet dhe fenomenet tjera.

Puna e tij shkencore karakterizohet me saktësi dhe meditim. Di t'i qaset problemit me konstruktivitet; edhe problemet më të rënda di t'ia ofrojë lexuesit, t'ia bëjë të kapshme dhe interesante. Qendrore në shkrimet e tij është të kuptuarit e drejtë të Islamit, duke u mbështetur në fundamentet e tij, pozita dhe perspektiva e muslimanëve në ballafaqim me kulturat dhe civilizimet aktuale dhe gjendja e brendshme e muslimanëve: ekspozimi i gjendjes faktorët që sollen deri këtu, a ka rrugdalje dhe cilët janë ato?!

Ilustrimi më i mirë për këtë është vepra “El-Iman” (Besimi Islam) (botim i Akademisë së Shkencave, e cila meqë e themeloi vetë M. El-Behij), të cilën lexuesit po ia ofrojmë të përkthyer në gjuhën shqipe. Vepra ka stil të lehtë, gjuhë të kuptueshme e të rrjedhshme, me plotë instruksione; paraqet sintezën e përsiatjeve të tij kur'anore-sunnetike; paraqet udhëzimin konkret drejt besimit të mirëfilltë: përkufizimin e besimit, vlerën, fuqinë, cilësinë dhe rëndësinë e tij, paraqet arsyeshmërinë fetare dhe racionale intuitive dhe meditative, fizike dhe praktike, që nga Edeni deri në Eskatos, nga ngahershmëria deri në përhershmeri.

5. Përkthimin e veprës “Imani” ia përkushtojmë autorit me rastin e 90 vjetorit të lindjes së tij. Ndërkaq i shpreh falenderim M. Hafizoviqit, përkthyesit në boshnjakishte, që na e ofroi këtë vepër në nënqiellin tonë. Falenderoj edhe të tjerët që mundësuan përkthimin dhe botimin e këtij

përktimi. Lexuesve u dëshiroj disponim gjatë leximit dhe mirëkuptim për lëshimet eventuale, sepse vetëm All-llahut i takon përhershmeria.

VEPRAT E M. EL-BEHIJ

1. Aspekti teologjik i mendimit Islam
2. Mendimi modern Islam dhe lidhja e tij me kolonializmin botëror.
3. Feja dhe shteti nga aspekti kur'anor
4. Feja dhe civilizimi botëror
5. Mendimi bashkëkohor Islam dhe problemi i familjes dhe solidaritetit
6. Mendimi Islam në zhvillimin e tij
7. Islami në realitetin bashkëkohorë ideologjik
8. Klasat e shoqërisë evropiane dhe manifestimi i saj në shoqërinë bashkëkohore Islame
9. Pesë traktate rinisë bashkëkohore muslimane
10. Islami në luftë për zgjidhjen e problemeve bashkëkohore të botës Islamike
11. Mendimi i fesë

12. Pikëpamje kur'anore e besimit dhe sjelljes
13. Islami dhe jeta e muslimanëve
14. Islami në shekullin e 14 hixhrij
15. Komentimi i xhuz'it “AMME”

ⁱ Huxhurat, 14 (ajetetet janë marrë nga përkthimi i Sherif Ahmetit)

ⁱⁱ Huxhurat, 14

ⁱⁱⁱ Huxhurat, 15

^{iv} Ali Imran, 186

^v Huxhurat, 16

^{vi} Nur, 55

^{vii} Bejjine, 7, 8

^{viii} Ankebut, 56-57

^{ix} Muxhadele, 20-21

^x Isra, 61-63

^{xi} Ali Imran, 104

^{xii} Junus, 99

^{xiii} Tin, 4

^{xiv} Insan, 2

^{xv} Junus, 99

^{xvi} Junus, 99

^{xvii} Nahl, 125

^{xviii} Nahl, 78

-
- xix Huxhurat, 17
xx Tevbe, 19
xxi Tevbe, 20
xxii En'am, 151
xxiii Nisa, 36
xxiv En'am, 151
xxv En'am, 152
xxvi En'am, 153
xxvii Nisa, 58
xxviii Nisa, 58
xxix Nisa, 58
xxx Mu'minun
xxxi Nisa, 59
xxxii Huxhurat, 11
xxxiii Shura, 10
xxxiv Nisa, 59
xxxv Huxhurat, 9
xxxvi Huxhurat, 9
xxxvii Huxhurat, 9
xxxviii Fussilet, 30
xxxix Bekare, 1-5
xl Gafir (Mu'min), 51-52